 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

PERFORM

Performing and Responsive Social Sciences



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET EISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

KUR SIGURIMI MERREJ ME SHKENCË

Kundera Popullit e Shtetit

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit
Kur sigurimi merrej me shkencë / Autoriteti për Informimin mbi
Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. – Tiranë : AIDSSH, 2019
... f. : me foto ; ... cm
ISBN 978-9928-4553-4-5

- 1.Shkenca dhe shteti
- 2.Sundimi komunist, 1945-1991
- 3.Veprimtaria subersive
- 4.Intelektualë
- 5.Dokumente
- 6.Shqipëri

323.2(496.5) (086)
929(496.5) (086)

KUR SIGURIMI MERREJ ME SHKENCË




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

PERFORM

Performing and Responsive Social Sciences



AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHITETIT

Falënderime

STUDIUES

Ledia Dushku
Albert Nikolla
Andi Pinari
Enriketa Papa-Pandelejmoni
Sonila Boçi
Joana Doda
Indrit Qehajaj
Doris Pasha
Kristi Kolçe
Enxhi Beka

FALËNDERIME TË VEÇANTA

Brikena Çabej
Lluka Qafoku
Leonidha Pepo
Eleva Domi
Ina Kasimati
Plator Kalakula
Mirela Kamsi
Tatjana dhe Marin Haxhimihali
Vytene Muschick
Delija Valiukenas
Ornela Arapi
Ardita Repishti

SHKRIMET

Fatmira Nikolli

ILUSTRIMET & DIZAJN

Grid Cartels

ISBN 978-9928-4553-4-5

Përmbajtje

Parathënie / 06

Sabiha Kasimati / 10

Eqrem Çabej / 18

Gjovalin Gjadri / 26

Arshi Pipa / 32

Aleks Buda / 38

Kolë Kamsi / 46

Petraç Qafoku / 52

Petraç Pepo / 58

Gjergj Kokoshi / 64

PARATHËNIE

Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme bashkëpunuan përgjatë një viti në ndërtimin e narrativës mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor, në vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri (1945-1954).

Projekti zuri fill në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe u fokusua në figurat e Gjergj Kokoshit, Eqrem Çabejt, Sabiha Kasimatit, Arshi Pipës, Aleks Budës, Petraq Pecos, Gjovalin Gjadrit, Kolë Kamsit dhe Petraq Qafokut.

Përgjatë këtij viti jo me pak sfida, nisma është materializuar me studime të qenësishme, duke rishqyrtuar mbi baza profesionale figura dhe personalitete të shkencës; duke ofruar akses në arkivat e AIDSSH-së dhe shpërndarë këtë informacion në një platformë ndërvepruese komunikimi e së fundi, me botimin në dy gjuhë të këtyre studimeve shkencore, për të rinjtë shqiptarë dhe të interesuarit e shumë jashtë vendit. Studimet analizojnë me imtësi punën, kontributin e shkencëtarëve dhe raportet që krijoi sistemi me ta, duke hedhur dritë mbi vështirësitë me të cilat u përballën.

Studimi i rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954) bashkoi punën kërkimore arkivore me misionin e Autoritetit për informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për hapjen e dialogut publik mbi të shkuarën.

Ky është vetëm njëri nga hapat për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe punës me arkivat e Sigurimit e më gjerë. Autoriteti do ta vijojë hulumtimin me personalitete të tjera të dhjetëvjeçarëve pasues, për plotësimin e kuadrit historik, social, politik, ideologjik e kulturor të komunizmit në Shqipëri.

Gentiana Sula
Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Një kulturë kujtese është rezultat i një bashkëveprimi të ndërlikuar mes shumë aktorëve, debateve dhe traditave. Si për individët edhe për grupet, kujtesa formon bazën e duhur për vetëbesimin dhe veprimet që i drejtohen së ardhmes.

Fituesi i Çmimit Nobel për Paqen dhe i mbijetuar i Holokaustit, Elie Wiesel ka vënë në dukje se sa e rëndësishme është të kombinohen përballja me të kaluarën me krijimin e një të ardhmeje demokratike dhe paqësore: “Është e gabuar të flitet për të shkuarën nëse nuk veproni në të ardhmen”.

Debatet publike dhe ndërveprimet kërkojnë rrefime që bazohen në analiza dhe prova historike. Shumë shpesh, debate të tilla publike janë përdorur për qëllime të caktuara politike duke dhënë informacione të njëanshme.

Autoriteti Për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ka kërkuar PERFORM- Performing and Responsible Social Sciences (Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme), një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të ofrojë mbështetje për kërkime në dosjet e ish- Sigurimit të Shtetit.

Ideja ishte të përqendroheshim në një grup të caktuar shoqëror, të identifikoheshin rreth 10 individë dhe të dokumentohej e të vlerësohej përmbajtja e dosjeve të tyre në Shërbimin Sekret.

Narrativa mbi hulumtimin historik do të vihej në dispozicion të publikut dhe do të kontribuonte në debate që bazoheshin te dëshmitë historike.

Qëllimi i PERFORM është të mbështesë kërkimet shkencore sociale dhe të kontribuojë në reformimin dhe proceset e ndryshimit në shoqëri, duke ofruar dëshmi nga hulumtimi tek vendimmarrësit, nga politikat e institucioneve te diskutimet publike.

Studimet e propozuara nga Autoriteti, i përshatëshin mandatit të PERFORM dhe do të ofronin mundësi për studiuesit shqiptarë që të nxirrnin në pah rolin dhe kontributin e tyre, në procesin e rëndësishëm

shoqëror të ballafaqimit me të kaluarën.

Elitat intelektuale shqiptare nuk kanë qenë shumë të përfshira në debatin publik sa i takon nevojës për të hapur dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, nevojën për t'u marrë me kujtesën historike dhe për të rehabilituar imazhin e figurave të rëndësishme si shkencëtarë, artistë etj.

Ky debat është dominuar kryesisht nga politikanët dhe mediat, duke lënë vetëm një hapësirë të kufizuar për kontributin e intelektualëve. Projekti kërkimor që Autoriteti i propozoi PERFORM-it do të krijojë hapësirë për studiuesit shqiptarë që të paraqesin studime të bazuara në dëshmi e dokumente për debatin mbi të kaluarën komuniste.

Një grup historianësh shqiptarë dhe stafi i Autoritetit, kanë përzgjedhur 10 shkencëtarë për këtë hulumtim. Këta shkencëtarë kanë qenë aktivë gjatë fazës së parë të regjimit komunist. Kërkimi historik në dosjet e tyre pritej të jepte një histori që hidhte dritë mbi fatin e tyre individual, por gjithashtu edhe për rolin e shkencës dhe kërkimit shkencor gjatë asaj periudhe.

Kjo broshurë përfshin historitë e 9 studiuesve, historitë e jetës së tyre gjatë fillimeve të regjimit komunist.

Në shpresojmë, se ky do të jetë fillimi i një procesi në të cilin Autoriteti mund të përdorë sistematikisht kapacitetin dhe kompetencat e studiuesve shqiptarë për të shqyrtuar dhe vlerësuar dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit për individë të përzgjedhur dhe për të ndarë me publikun historitë e tyre.

Dua të shpreh vlerësimin tim për bashkëpunimin shumë të mirë me Autoritetin dhe grupin e studiuesve që punuan në këtë projekt.

Beograd, shkurt 2019

Dr. H.Martin Dietz

Drejtues

PERFORM, Performing and Responsive Social Sciences



Historitë

Jeta e shkurtër e shkencëtares antikomuniste

Vajza që dikur kishte lënë Turqinë e mandej Italinë për të bërë muze shkencash e studime shkencore, ishte tepër e lirë për Tiranën që kërkonte një tjetër model të gruas komuniste.

Kur më 1927, në moshën 15-vjeçare, Sabiha Kasimati vinte për herë të parë në atdhe, nuk e dinte se ky udhëtim do ta shënjonte përgjithnjë jetën dhe vetë fundin tragjik të saj. Rruga e përshkuar me karvanët e kohës, tronditjet a frika e sulmeve, sot, duket se i paracaktoi fatin në dy dekadat e ardhshme, me gjurmët që la, e gjurmët që ju fshinë në vendin prej ku kishte rrënjët. Ende adoleshente, e rritur në Adrianopojë (Turqi) ku kishte lindur në kohën që Shqipëria shpallte pavarësinë prej Perandorisë Osmane, asgjë prej saj, nuk të fliste për një vajzë të Orientit. I ati, Abdurrahmani, ishte mjek në zë, me lidhje të thella me elitën intelektuale e politike të shtetit shqiptar që rrekej të modernizohej.

Kasimatët u vendosën në Korçë dhe Sabihaja, si i vëllai, filloi Liceun Kombëtar. Në shkollën e

njohur si Liceu Francez ajo mori mësim nga një staf i ardhur nga perëndimi, me mësues shqiptarë e frëngë, që përtej programit mësimor bazë me lëndë të shkencave ekzakte e shoqërore, orientonin edhe bazat e formimit të nxënësve si qytetarë. Niste që në atë moshë për Sabihanë, ndjekja e jetës kulturore dhe njëherësh njohja me lirinë e mendimit e veprimit.

E ardhur nga një familje e mirë, njohëse e disa gjuhëve të huaja, mes të cilave fliste rrjedhshëm frëngjishten, me bukurinë dhe ëmbëlsinë që përcillte portreti i saj, vajza e vetme e shkollës ishte e çlirët, çapkëne, e zgjuar dhe me rezultate të larta në mësim. Duke qenë një ndër të paktët institucione arsimore të kohës, mendohet se Sabihaja mund të jetë njohur aty, edhe me Enver Hoxhën që ka kryer të njëjtën shkollë e që vite më pas do të instalonte regjimin komunist në vend. Pasi mbaroi Liceun, ajo



Kundera Popullit e Shtetit

LETËR-RRESHTIMI

Unë Kapiten i I-re Fadil Kapisyzi (5)

qënë se i quajturi Sabiha Kasimati i biri i Abdurrëmanit

i Vojo Kushi nga Bari-katave bashkë me Ar. 99

profesion N.Punes në shënjë

porë së veçanta që pasojnë

filloi punë në Shkollën Amerikane të Kavajës më 1932, më pas u rikthye në Lice si mësuese e klasave të ulta, por për shkaqe shëndetësore e la shpejt dhe u punësua si mësuese e frëngjishtes në Tiranë në Institutin Femëror “Nana Mbretneshë”.

Më 1936 Sabihanë e gjejmë në Torino të Italisë, ku ka nisur studimet e larta në Fakultetin e Shkencave

nën titullin “Fauna Iktiologjike e ujërave të ëmbla të Shqipërisë”. Shqipëria e pushtuar nga fashistët gjatë kohës që ajo ishte në Torino vijon të jetë nën pushtim, kur Sabihaja kthehet nga studimet. Më 1941, është mësuese e shkencave, kimisë dhe higjienës në Shkollën Normale Femërore “Nana e Skënderbeut”. Dy vite më pas detyrohet të shkëputet për shkak të tuberkulozit dhe nis kurimin në Itali.



Sabiha Kasimati / Arkiva e familjes

E ardhur nga një familje e mirë, njohëse e disa gjuhëve të huaja, mes të cilave fliste rrjedhshëm frëngjishten, vajza e vetme e shkollës ishte e çlirët, çapkëne, e zgjuar dhe me rezultate të larta në mësimet.


të Biologjisë, me bursë nga shteti shqiptar. Natyra e saj dhe guximi për të ngritur zërin del herët në pah, kur si studente nënshkruante një kërkesë drejtuar Ministrisë shqiptare të Arsimit që t’u jepte mundësinë nënshtrimit të saj, të jepnin provime edhe në sezonin e vjeshtës, duke pasur parasysh problemet me gjuhën italiane e mungesën e teksteve. Punën e saj të parë shkencore, nëse mund ta llogarisim të tillë tezën e diplomës, ia kushton vendit të origjinës,

Por, para se të ikte, kishte hedhur hapin e parë, në formësimin e njëjës prej ideve më të qenësishme si grua e shkencës. Ishte ftohtë në 12 janarin e 1943-it, kur mësuese Sabihaja takonte kryetarin e Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare, Ernest Koliqin, me të cilin njihej prej kur ajo ishte studente e ai ministër i Arsimit. I thoshte në vija të përgjithshme atë që më pas ia paraqiste përmes një projekti të detajuar në letër. Ajo propozonte krijimin

e “një koleksioni zoologjik, tue filluar nga Dega e Iktiologjisë”, për të cilën kishte mbrojtur diplomën; përgatitjen e “një ‘erbario’ mbasi flora shqiptare, ka provuar interesimin e botanistëve më të çqar, sidomos gjerman dhe t’Europës përgjithësisht” si edhe mbledhjen “në bashkëpunim me Drejtorinë e Minjereve pranë Ministrisë s’Ekonomisë, e llojeve të ndryshme të mineraleve dhe të fosileve që

teknikë shqipe, gjë që do të pasuronte mjaft gjuhën t’onë kombëtare”.

Po ndërtonte një kështjellë në shkretëtirë. Dhe e dinte. Atëkohë ishte veçse 31 vjeçe, e re, e bukur, e zgjuar, elegante, e veshur me sqimë, e shkolluar, e formuar, ishte e bija e një mjeku, e ishte edhe motra e një mjeku, e një inxhinieri dhe një juristi. Ishte një grua



Dokumentet e përndjekjes dhe dënimit të Sabihës / AIDSSH

gjinden në shtresat e tokës në Shqipëri”. Sabihaja i thoshte Koliqit se për këtë duhej një bibliotekë me vepra shkencore, bibliografinë e së cilës e kish bërë gati dhe se duhej ngritur edhe një laborator studimesh mikroskopike për kërkime shkencore. Duke kuptuar mangësitë shqiptare në këtë lami, vërente se “do të kishin një randësi të lartë nga pikëpamja gjuhësore... të caktoheshin njëherë e mirë në rast se nuk ekzistojnë emrat dhe temat

e lirë, në një qytet që rrekej të linte pas fashistët, e të mësohej me nazistët. Por teksa në Tiranë gjëmonin armët, vizioni i saj shkencor e injoronte, a mbase më mirë e sfidonte luftën. Një muaj pas propozimit të saj, në messhkurtin e të njëjtit dimër, Instituti Mbretnuer i Studimeve vendos të ngrrejë një muze të shkencave dhe ngarkon Sabihanë të merret me të. Ajo e nis punën me përshkrimin e materialeve që duheshin dhe librave për bibliotekën e muzeut.

Ikja e pushtesve, çlirimi i vendit dhe instalimi i një sistemi të ri politik nga fitimtarët e gjen atë të përkushtuar në kërkimin shkencor. Është në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe më 1946 bashkë me Gjergj Komninon dhe grupin e drejtuar nga Eqrem Çabej, është marrë me skedat në gjuhën shqipe për termat e shkencave të natyrës. Është ende aty kur qeveria e re e riorganizon Institutin më 1947 dhe vë në themel të punës së tij ideologjinë marksiste-leniniste. Dokumentet shtruese që kanë shqyrtuar studiueset Ledia Dushku dhe Doris Pasha për studimin mbi të cilin bazohet ky artikull, nuk japin të dhëna për raportet që ka pasur Kasimati me Institutin e Studimeve gjatë regjimit komunist. Prej tyre, kuptohet vetëm se nga qeveria e ardhur pas çlirimit nuk shiheshin me sy të mirë shtresat e intelektualëve të pasqaruar mbi pozicionin e tyre gjatë luftës, të shkolluarit në perëndim, ata që e kanë mbështetur pushtuesin ose ata që kanë qenë indiferentë, siç kishte qenë biologja Kasimati.

Por nevoja për zhvillim ekonomik i jepte rëndësi shkencave të natyrës dhe Kasimati si e para iktiologje boton në "Buletinin e Shkencave" më 1948 artikullin "Probleme të peshkut dhe të peshkimit në vendin tonë". Pasi jepte shumëllajshmërinë e peshqve, cilësitë e ujërave dhe mundësitë prodhuese të tyre, numëronte pa drojë për kohën edhe mangësitë e shumta, që nga varkat, transporti e konservimi. Veç anës kritike, studimi i Sabihāsë ofronte edhe zgjidhje të mundshme duke propozuar që nga organizimi i peshkimit deri te përdorimi i mjeteve moderne a citimi i ligjeve ndërkombëtare. Janë të guximshme kritikata e saj të drejtpërdrejta, nëse kemi parasysh se regjimi i kohës, në vitet 1946-1947 e kishte treguar tashmë natyrën e tij hakmarrëse ndaj kundërshtarëve, madje vetë Sabihaja kishte njohur tronditjen e humbjes së miqve të afërt.

Megjithë erën e frikës që ndjehej mes intelektualëve, ajo vijoi punën për përgatitjen e

monografisë "Peshqit e Shqipërisë" siç mësohet nga plani i punës së Institutit të Shkencave. Më 1948 botimi i veprës u shty dhe Sabihaja vijoi ekspeditat për peshqit e ujërave të kripur në Shqipëri më 1949. Studimi u përfundua dhe u botua më 1950, siç del në dritë në të dhënat e Institutit të Shkencave dhe dokumentet e Sigurimit të Shtetit, por në mënyrë të pashpjegueshme, në ditët tona nuk ka mbërritur asnjë kopje e tij. Në raportin e bashkëpunëtores së Sigurimit të Shtetit me pseudonimin "Prurësja", më 27 prill 1950, del që Kasimati i ka rrëfyer se "...Tash kemi shpënë në shtypshkronjë një broshurë për t'u botuar; është vepra ime, pjesën më të madhe më ka ndihmuar dhe Çabeu. Sot këtë broshurë vajta dhe e mora nga shtypshkronja. Ju thashë atyre se e kërkon Komisioni i Kontrollit..."

Ndonëse ishte procedurë që të dënuarve nga regjimi ju ndalohej dhe ju bëhej vepra karton, për librin e mësipërm, nuk ka asnjë gjurmë as në skedat dhe dokumentacionin e Bibliotekës Kombëtare. Hipotezën e përhapur se studimi i Sabiha Kasimatit është përvetësuar dhe është botuar më 1958, me të njëjtin titull nën autorësinë e tre emrave të tjerë, studiueset Ledia Dushku dhe Doris Pasha e kanë gjetur të vështirë ta provojnë.

Shkollimi në Perëndim, origjina familjare, formimi liberal, natyra e guximshme dhe e çlirët për të thënë hapur mendimin e saj kritik qoftë ky në kundërshtim me propagandën e shtuar të regjimit, rrethi i njerëzve me të cilët shoqërohej disa prej të cilëve me të afërm në burgje, besohet se ishin arsye që e vendosën Sabiha Kasimatin në vëzhgimin e Sigurimit të Shtetit. Por sa i takon kohës që filloi përndjekja, sa zgjati dhe çfarë e përcaktoi vendimin për të, ka shumë pikëpyetje. Dritëhijet janë të mëdha duke qenë se në Arkivin e Sigurimit nuk është gjetur një dosje me emrin e saj dhe të dhënat për Sabihanë janë marrë nga dosjet e atyre me të cilët ajo shoqërohej.



Sabihaja në Itali me të afërmit në vitet '30 / Arkiva Familjare

Në raportet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, ajo shfaqej kritike ndaj reformave të qeverisë, politikave të ndjekura, varfërisë dhe e shprehte hapur pakënaqësinë ndaj pushtetit, medias së kontrolluar prej tij madje edhe fjalimeve të mbajtura nga një njeri i pushtetshëm si gjeneral Mehmet Shehu mbi moralin e të rinjve.

Në raportet e bashkëpunëtorëve të Sigurimit, ajo shfaqej kritike ndaj reformave të qeverisë, politikave të ndjekura, varfërisë dhe e shprehte hapur pakënaqësinë ndaj pushtetit, medias së kontrolluar prej tij madje edhe fjalimeve të mbajtura nga një njeri i pushtetshëm si gjeneral Mehmet Shehu mbi moralin e të rinjve. “Shtypi dhe radio thonë se amerikanët i ushqejnë t’arratisunit me mish kali, por ky i këtyre kutive këtej ç’a është vallë? Se neve nuk i kemi as këto. Rrallë na bie t’i kemi, edhe këto me ndërmjetësinë e miqvet tonë”, shprehej ajo sipas raportit të spiunes.

Sabihaja e kritikonte regjimin më 1950 me të njëjtën gjuhë që mund ta bëjë dikush sot në liri, kur thoshte “udhëheqësit tanë kur duanë të venë ndonjë tjetër në Komitetin Qëndror që e kanë më të besimit, heqin ndonji që e kanë pasur... I venë ca akuza të kota, në qoftë se ay i ka zbatuar, prapë me urdhërin e tyre i ka zbatuar”. Janë të guximshme për kohën sa mendimet edhe qëndrimet e saj, kur rezulton se Kasimati ishte në dijeni të mënyrës se si pushteti vepronte me qytetarët. “Prurësja” e zgjedhur nga Sigurimi ta ndiqte raportonte se Kasimati “takohet me kaptera dhe gra të cilat kanë burrat kriminelë me damkë”.

Në raportin zyrtar për Institutin e Shkencave në 3 shtatorin e 1950-ës, Sabiha Kasimati përshkruhej se “as politikisht as ideologjikisht” nuk kishte gjë të përbashkët me sistemin dhe madje shihej se as që mund të korrigjohej. Ishte koha që iluministët francezë zëvendësoheshin me Marksian.Por vrojtimit disavjeçar i vjen fundi. Më 20 shkurt 1951, pas vënies së bombës në Legatën Sovjetike, Sabihaja do të arrestohej bashkë me 21 intelektualë të tjerë të akuzuar për sulm terrorist.

Dosja hetimore i numëronte disa ‘mëkate’: “gjatë okupacionit ka pasur marrëdhënie me elementë fashistë, shqiptarë e italianë. Mban qëndrim armiqësor ndaj pushtetit, flet kundër reformave

dhe mban kontakte me elementë armiq... Ka pasur kontakt me deputetin anglez Lester Hutchiston. Ka mbajtur kontakte me njerëz të misionit anglez... dhe me J.S.Payne me të cilin ka pasur lidhje të ngushta. Armike e betuar e pushtetit të sotëm. Ka urrejtje karshi tij dhe sidomos karshi komunistëve, kritikon moralin komunist etj”.

Procesverbali i mbajtur nga Gjykata Ushtarake, pretendon se Kasimati e ka pranuar një pjesë të akuzave dhe ajo citohet të ketë thënë: “Kam qenë kundra pushtetit popullor sepse nuk përputhet me ideologjinë time. Unë nuk kam qenë kurrë e mendimit, që me akte revolucionare të arrihet në komunizëm, jam lidhur me një grup shokësh te cilët edhe ata kanë qenë armiq të partisë Komuniste. Ndër shokët e grupit tim ka pasur edhe njerëz që mendonin se duhet të hidheshin në aksione kundër pushtetit. Unë vetë nuk kam kryer ndonjë atentat dhe as që kam marrë pjesë në ndonjë mbledhje, ku është marrë vendim për akte terroriste. Ka bërë vaki që të kem folur se një luftë e re është e paevitueshme dhe se kjo është në interes të popullit shqiptar”. Një javë pas arrestimit, Sabihaja dhe 21 intelektualët e tjerë ekzekutohen, pa ju dhënë mundësia të kundërshtojnë vendimin. Studiuesit e vënë në dyshim procesin hetimor dhe kanë arritur në përfundimin se janë falsifikuar procesverbalet nga Gjykata Ushtarake, pas ekzekutimit pa gjyq të 22 pafajshmëve, mes të cilëve edhe Sabihaja.

Vetëm një javë e përcolli nga jeta në liri drejt vdekjes. Ajo ende nuk i kishte mbushur 39 vjeçe, kur ia prenë jetën në mes. Familjarët besojnë se u vra ngaqë në një letër dërguar Enver Hoxhës, ose në një takim me të, e ka kritikuar për qeverisjen dhe se që pikërisht ai që ia vuri emrin në listën e atyre që duheshin ekzekutuar. Megjithëse janë konsultuar me të gjitha arkivat e vendit, Ledia Dushku dhe Doris Pasha, mbi studimin e të cilave bazohet ky artikull, nuk kanë gjetur një dokument që vërteton një letër të tillë. Familjarët kanë rrëfyer

edhe se një zyrtar i lartë komunist, mik i saj, e kish ftuar në kafe për ta këshilluar “duhet të mbyllësh gojën jo me karficë, por me babushkë...”

Rrëfimet nuk mjaftojnë për të kuptuar çfarë ka menduar, çfarë ka dashur të bëjë, sa i ka dhembur dhe si e ka luftuar kohën. Në fund të një studimi që ka shfrytëzuar disa burime, e vetmja gjë që mund të thuhet, është se Shqipëria komuniste nuk kishte vend për një grua të lirë, që kishte qenë indiferente

Kam qenë kundra pushtetit popullor sepse nuk përputhet me ideologjinë time. Unë nuk kam qenë kurrë e mendimit, që me akte revolucionare të arrihet në komunizëm, jam lidhur me një grup shokësh te cilët edhe ata kanë qenë armiq të partisë Komuniste.

gjatë luftës e që ishte kritike pas luftës, për atë që po bëhej atdheu i saj. Vajza që dikur kishte lënë Turqinë e mandej Italinë për të bërë muze shkencash e studime shkencore, që tepër e lirë për ta lejuar të jepte shembullin e saj në Tiranën që kërkonte një tjetër model të gruas komuniste.

Vajza e re që erdhi e struktur në krahët e të atit, nuk u la të thinjej. Mbeti përjetësisht e re me pengjet e atyre që nuk e lanë t'i bënte.

40 vite pas vdekjes, kur regjimi po shkërmoqej, një vendim i Gjykatës së Lartë e shpalli të pafajshme. Sot, "Nder i Kombit", 67 vite pas natës kur zëri u saj u shua përgjithnjë duke lënë pas heshtje, pikëpyetje

e barrën e dhimbjes, një godinë e gjelbër në rrugën e Tregut Elektrik në kryeqytet, mban në ballinë emrin e saj. Në krah të majtë të derës, një kënd kujtese shfaq portretin e saj me një buzëqeshje të ndalur në kohë. Duket sikur amaneti i Sabihasë ka marrë jetë, por tanimë duke i njohur meritën. Për të "evolucioni është në natyrën e gjërave" dhe koha provoi se kishte të drejtë.



Sabihaja në Itali me të afërmit / Arkiva Familjare



Të mbijetosh përmes heshtjes

Regjimi e la gjallë sepse Çabej kishte heshtur. Jeta e tij, pavarësisht se nuk la të shkruara kujtime e ndjesi, mund të mendohet si një luftë në heshtje me armiqtë që e dinte se e ndiqnin.

Një vilë e verdhë dykatëshe në rrugën 'Qemal Stafa" mbledh herë pas here në Tiranë shkrimtarë e njerëz të letrave. Ka një oborr të bollshëm kur ndjen hapat e shpenguar dhe trokitjet e gotave. Zëra të shumtë që gumëzhijnë me njëri-tjetrin, flasin për libra, botime, studime dhe kujtime.

E kam të lehtë tani të imagjinoj Eqrem Çabejn, mbasi kish studiuar jashtë e bartte në kokën e vogël hollake një enciklopedi të tërë, pas një rinie të kaluar në Vjenë e në Romë, që i mësuar me festa si këto e me biseda si këto, papritur, ju desh të reshtte dhe i kushtëzuar nga rrethanat e diktuar nga regjimi komunist, ta detyronte veten „të izolohej“ në lirinë që i ishte lënë.

Brikena, e bija, e mban mend t'et të qetë e të qeshur, me krye mbi libra aty në dhomën e letrave ku ruan akoma shënime e dorëshkrime. Ishte ai katërkëndësh i vogël streha e tij e lirisë. Siç zbulon

studimi i Ledia Dushkut, arsyeja pse ai mbeti gjallë që dija e tij, e në këtë vazhdë megjithë rrekjet e herëpashershme, regjimi nuk ia doli t'i gjente jo vetëm pasardhës po as zëvendësues. Atë që e rrezikoi dija e tij, e mbrojti po dija e tij.

Ndaj kjo, është historia e një burri - një prej më të zgjuarve që ka pasur vendi ynë; është historia e një burri që barti mbi vete dhembjen e madhe të humbjes së miqve, dhembjen e lirisë së kontrolluar e të rrezikuar; mbase edhe frikën se dija vret, se mendimi vret, se aftësia vret, se kultura e formimi vret; është historia e një burri me të cilin do të duhej të krenoheshim pa drojë, që kur ai ishte gjallë dhe frymonte, pa prituri që vitet të kalonin e të gërmonim për të gjetur historinë e tij; ne, do të duhej të na e kishte rrëfyer vetë ai historinë e tij dhe historia e tij, nuk do të duhej të ishte kjo që po tregojmë.

Është 6 gushti i 1908-ës kur në Eskishehir pranë Ankarasë në Turqi gjyqtarit Hysen Çabej i lind djalë.

E quan Eqrem dhe kur kërthiu është vetëm 6 muajsh, Hyseni kthehet me familjen në Gjirokastrë. I vogli do e njihje gjithë jetën këtë qytet si vendlindjen e tij. Aty kaloi fëmijërinë dhe kreu shkollën fillore dhe atë qytetëse. Kur ishte 12 vjeç me bursë të shtetit shqiptar Hyseni e çon të birin për shkollim në Austri ku vijon edhe Universitetin e Grazit dhe Vjenës. Eqremi tanimë djalosh specializohet në Linguistikë të Përgjithshme e Indoevropiane e në Albanistikë. Njihet aty me profesor Nobert Jokli-n, një prej albanologëve

një bursë prej 23 mijë frangash me kushtin që pas studimeve t'i shërbente shtetit 7 vjet, ose t'i kthente të hollat e marra.

Riosh e nga një familje e mirë, Çabej fill pas kthimit punon si profesor i letërsisë dhe gjuhës shqipe, në Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë e Tiranë, madje mban edhe detyra si drejtues në shkolla e në Ministrinë e Arsimit të kohës. Relacionet flasin për një profesor me prirje liberale që respekton mendimin



Çabej gjatë të '30ve / Arkiva e familjse

**Që prej fillimit, qeveria
komuniste e etiketoi
Çabej si një element të
rrezikshëm që është
ideologjikisht dhe
politikisht problematik**

më në zë të kohës, që do të bëhej udhërrëfyese i tij drejt dijes. Mes profesorit e studentit u krijua një raport miqësor e me nxitjen e tij, Çabej hodhi hapat e parë në kërkimin shkencor duke vijuar doktoraturën për Studime italo-shqiptare ku mori gradën doktor në Vjenë. Universiteti i propozoi djaloshit shqiptar të qëndronte si asistent i Joklit, por Çabej refuzoi. Ai u kthye në Shqipëri ku në 13 vite i ishte dhënë


e nxënësve. Ka nisur ndërkohë botimin e artikujve në revista shqiptare si "Hylli i Dritës" por edhe në ato ndërkombëtare, e ka botuar më 1936 librin për shkolla "Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe".

Emri i tij po bëhej i njohur. Është drejtor i Liceut të Tiranës kur më 1940, fashistët ankohen se ai është


“i vetmi person përgjegjës për veprimet e këqija të kryera nga studentët e Liceut në demonstratat e njohura të 28 Nëntorit 1939”. Ankohen edhe se Çabej nuk ka treguar shenjë afrimi me politikën fashiste, cilësohet i rrezikshëm ndaj merren masa për ta shkarkuar nga detyra. 32-vjeçari Çabej dërgohet në Itali deri më 1944 dhe ngarkohet të punojë për Atlasin Gjuhësor Shqiptar në Akademinë e Shkencave në Romë. Gjatë qëndrimit atje, kohë që e quante internim, Çabej është i lidhur me fatin e

personalisht, veçse njihet botërisht si armik i rreptë i racës shqiptare”.


Më 1942 fashistët e më 1943 nazistët, do t'i propozonin postin e ministrit të Arsimit në qeverinë e Tiranës. Ai nuk pranoi, sepse siç tregoi më vonë “nuk pajtohej me nderin tim shqiptar dhe me të mirën e vendit dhe të popullit tim”. Përtej njeriut që nuk donte të merrej me politikë, për studiuesen Ledia Dushku dhe të bijën e Çabejt, ai nuk mund të bëhej ministër



Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike



Fjala e Enver Hoxhës 24/02/1954



27/09/1942

atdheut dhe anëtar i rregullt i Institutit Mbretnuer të Studimeve Shqiptare. Si ai, anëtar i rregullt në Institut ishte edhe një prift italian albanolog për të cilin në Shqipërinë e kohës kishte polemika. Ndaj megjithëse ende në pushtim, më 1942 Çabej i shkruante një letër të guximshme kryetarit Ernest Koliqi, ku i kërkonte t’ia hiqte emrin sepse “[Anëtar] i këtij Instituti figuron Atë Fulvio Cordignano, të cilin unë vërtet as nuk e njoh

i nazistëve kur ata i kishin vrarë profesor Nibert Joklin “babanë e tij shpirtëror”.

Kishte kaluar katër vite në Romë, kur Eqremi, i vritet vëllai Selahudini, nënprefekt i Tropojës çka e bën të kthehet. Lufta ishte drejt fundit, partizanët po shpallnin fitoren kur ai nis punë në Ministrinë e Arsimit dhe vijon angazhimin në Institutin e Studimeve

Shqiptare me skadat në shqip për shkencat e natyrës me Sabiha Kasimatin dhe Gjergj Komninon.

Por mbarimi i luftës dhe instalimi i sistemit komunist e ndryshoi tërësisht raportin mes shkencës dhe shtetit. Në vend që shkenca 'të diktonte' politikën, ishin këto të fundit që diktonin shkencën. Enver Hoxha në fjalimet e mbajtura kërkonte që shkenca të ishte "në shërbim të masave punonjëse" dhe e mbrujtur me frymë partie. "Njeriu i ri" që kërkohesh duhej të

cilësohej që në fillim prej regjimit të ri si element i rrezikshëm, me probleme ideologjike e politike. Për njerëz si Çabej, Partia Komuniste kërkonte që ata të bashkëpunonin me regjimin ose siç koha e tregon, ekzekutoheshin, burgoseshin, internoheshin.

Është shtatori i vitit 1946 dhe doktori i shkencave Eqrem Çabej është 38 vjeç kur Sigurimi i Shtetit e vë në përgjim. Një shënim i datës 29 të atij muaji interpreton jetën e tij me tone akuzash: "Çabej



Çabej dhe gruaja e tij, Shyhreti / Arkiva e familjes

Në 1948, Çabej qëndroi në kontakt me 62 persona, në 1953, numri zbriti në 17. Dhe në 1956 ai takoi vetëm 2 persona jashtë rrethit të tij të ngushtë familjar

mendonte si Hoxha. Po sa mundej një intelektual i kalibrit të Çabejt, të përshtatej me kushtet e reja të të menduarit si Partia?

Për shkak të formimit dhe jetës më shumë se 30-vjeçare mes Europës e Shqipërisë, Çabej pozicionohej natyrshëm te elita e vjetër, pa parti, të shkolluar jashtë, që vinin nga familje të mëdha dhe që nuk mund të pranonin një regjim që më së pari u merrte lirinë. Të gjitha këto u bënë shkak që ai të

në kohën e fashizmit ishte dërguar në Itali... Ka patur marrëdhënie të mira me gjermanët se këta e emëruan ministër, mirëpo ky nuk pranoi... Dysohet se ka qenë besnik tek gjermanët sa të liroj dhe të dërgoj në Shqipëri 30-40 shqiptarë të internuar prej italianëve".

Sa i takon liritë të shqiptarëve të internuar gjatë fashizmit, e bija Brikena Çabej dhe rrëfime të dëshmitarëve si shkrimtari i njohur Petro Marko nxjerrin

anën tjetër të ngjarjes. Në Ambasadën Gjermane në Romë punonte një shok shkolle nga Vjena tek i cili Çabej mundi të merrte një shkresë që lejonte Petro Markon të mblidhte nëpër Itali të burgosurit dhe të internuarit shqiptarë e t'i riadhesonte.

Por shërbimet për shtetin dhe ato që duhej të ishin asete për të ardhmen e tij, si studimet e kryera në Austri, njohja e disa gjuhëve të huaja, prejardhja nga një familje e pasur, përvojat e punës, bashkë me miqësinë me elitën intelektuale të kohës u kthyen për të në njolla të errta që lajmëronin rrezik. Faktet e jetës së tij manipuloheshin në relacionet e Sigurimit të Shtetit kur shënohej se “okupacionin fashist e ka pritur mirë, duke e përhapur dhe deklaruar si mik të popullit tonë”.

Sigurimi i Shtetit më 11 tetor të 1950-ës, e cilëson “armik të pushtetit popullor”, me një kunat të arratisur si ballist dhe me vëllanë e vrarë nga partizanët para çlirimit. Shtuar kësaj, agjentja “Prurësja” raportonte se në takimet mes Çabejt e Sabiha Kasimatit, “bisedohet rreth kulturës, shkencës dhe veprave ... të shkrimtarëve me kulturë borgjeze. Kultura marksiste për ta konsiderohet si hiç gjë, veprat e Leninit jo si kryevepra, por si ngjarje të rastit”.

Dy vite më vonë, miqtë e tij më të mirë përfshi Sabiha Kasimatit ishin ose të ekzekutuar ose përgjoheshin ndërsa vetë ai cilësohej se kryente “aktivitet antipopullor, kundra atdheut dhe popullit”. Thuhej se në Vjenë ka marrë tendencat naziste, i përmendej Roma, dy propozimet për ministër dhe theksohej se “asht parë të shoqnohet me elementa të dyshimtë”. Ishte koha kur Eqremi, tanimë 44-vjeçar po takohej me Shyrete Kurteshin, e përjashtuar nga partia, eurvejuar dhe bashkëshortja e tij e ardhshme.

Në vitet 1952-1955 Sigurimi harton gjashtë plane masash për përgjimin e Çabejt dhe i vë pas gjashtë agjentë me pseudonimet ‘Prurësja’, ‘Drojtja’, ‘Edija’, ‘Dhelpra’, ‘Çajupja’ dhe ‘Taraboshi’.

Tanimë ndiqet çdo moment, i kontrollohet puna që bën, korrespondenca, me kë shoqërohet, ku shkon, kë takon nga Instituti në Bibliotekë Kombëtare a rrugës për në shtëpi, deri madje dhe hyrje-daljet në shtëpi.

Për të, nuk po gjendej asgjë e rëndë. Një ish-student i tij, e më pas koleg që si bashkëpunëtor i Sigurimit raporton me pseudonimin “Edija”, thotë se ai ka kulturë borgjeze, është mjaft i zgjuar e inteligjent, por dinak. Madje shton se që në kohën e Zogut, “kur vendi i zakonshëm për shumicën e profesorëve ishte kafeneja, ky studionte, nuk është njeri i bixhozit”. Ish-studenti spiun raporton se Çabej mendon se “Ka disa njerëz të mëdhenj që qëndrojnë mbi politikën, nuk interesohen, se përfillin fare”. “E tha me pasion këtë”, - thekson “Edija”, - „aq sa më dha të kuptoj se ishte i bindur se një qëndrim i tillë ishte i përshtatshëm për njerëzit e mëdhenj, prandaj ai e mbante...”. Komunistët e shihnin si mendjemadh, që nuk pajtohej me luftën e klasave dhe çështjet shkencore i shihte të ndara nga politika, duke sfiduar kështu ideologjinë e kohës.

Teksa përgjohej në çdo hap e në çdo mendim, pyetja është si i shpëtoi ai vdekjes? Përgjigja do të ishte: heshti e nuk foli, me askënd, për asgjë. Duhet të ketë qenë e dhimbshme për të, të shihte se si miqtë më të mirë i vriteshin. Ai duhej ta ketë kuptuar shpejt edhe se pse. E kur shumë miq regjimi ia mori duke ia vrarë, ai rralloi takimet me të tjerët të mbetur gjallë. Dosja e tij në Sigurimin e Shtetit tregon se numri i njerëzve që ai takon mpaket vit pas viti. Nëse më 1948, Çabej kishte kontaktuar 62 persona, në vitin 1953 vetëm 17 ndërsa më 1956-ën gjatë 5 ditëve tëurvejimit, ai kishte takuar jashtë famijes, vetëm 2 veta, njëri prej të cilëve ishte i vjehri.

E bija në një intervistë për studimin e Ledia Dushkut mbi të cilin bazohet ky artikull, e përshkruan të atin si:

“njeri i matur, i qetë, me një edukatë të pabesueshme. E kam parë shumë rrallë të humbiste durimin dhe të nervozohet. Zakonisht kur e bënte këtë, ikte nga dhoma. Nuk shante njeri dhe konfliktet i evitonte si të mundej. Kishte parime, të cilat nuk i shkelte kurrë. E dinte fort mirë se ku ishte dërrasa e kalbur dhe i qëndronte larg. Nuk ankohej, megjithëse nuk ka bërë jetë të lehtë. Për gjërat që i dhembnin nuk fliste kurrë...”

Kjo ishte arsyeja e parë pse e lanë gjallë, ndërsa e dyta ishte nevoja që patën për të. Prej 1950-ës puna në Institutin e Shkencave ishte nën lupën e partisë. Vetë Enver Hoxha që kontrollonte raportet shprehej se “ne e dimë... se çfarë elementi është Eqrem Çabeu, por duhet të përpiqemi që ta bëjmë të punojë”. Diktatori do ta përmendte emrin e Çabejt në mbledhje çdo dy vite duke vënë në dukje ‘të metat e tij’ kur raportet e Institutit dhe të Sigurimit i thoshin edhe aftësitë. Ndonjëherë kur zbutej gjuha me intelektualët e vjetër, Hoxha kërkonte mënyra paqësore të punës me ta, jo ato policore e të dhunshme, por kishte vite si ai 1954, kur diktatori shprehej se “diturija e njerëzve si Sejfulla Malëshova, Eqrem Çabej, etj., ...nuk na vlen për në Institut”. Kur më 1955 emri i Çabejt qe propozuar të hiqej nga Instituti i Shkencave bashkëshortja e diktatorit, Nexhmije Hoxha, drejtore e sektorit të Agjitacionit e Propagandës do e zbuste situatën duke thënë:

“Për Eqrem Çabejin, po të nisemi nga ana politike mund të hiqet, por unë them se ai nuk duhet të hiqet, duke marrë parasysh se ai sot [shkencërisht] punon për neve”.

Në këtë kohë, Çabeji ishte i pazëvendësueshëm: po bënte transkriptimin e veprës më të vjetër në shqip, “Mesharit” të Gjon Buzukut (1555). E cilësuar si punë murgu, ajo do t’i merrte 8 vite kohë dhe qe

një detyrë që iu dha me urdhër duke e detyruar të linte mënjatë “Atlasin e Gjuhës për Historinë e Letërsisë Shqipe” që sipas kolegëve që ankoheshin, ngurronte ta bënte. “Meshari” jo vetëm nxori në pah domosdoshmërinë e dijes së Çabejt, por u bë mbase edhe shpëtimtari i tij. Atij ju tolerua të shkruarit sipas ideologjisë ‘borgjeze’ sepse siç raportonte “Edija” Çabej “njeh gjithë anën teorike të shqipes, çfarë është thënë mbi të nga linguistët e mëdhenj” dhe “nuk e nxjerr kurrë punën nga dora kur s’ka përfunduar si duhet”.

Pas 1955-ës, jepet leja që ai mund të udhëtojë edhe jashtë vendit me delegacione. Mbas 10 vitesh presion ndaj tij, nis politika e lirim-shtrëngimit. I jepen dy çmime të larta pas vitit 1961 dhe Çabeji që në dosje kishte qenë “armik i popullit” në fjalimet e Hoxhës përmendet si “mik i vjetër” dhe “profesor me rezultate të shkëlqyera”. Nëse ky burrë i mençur ia doli të bëjë kaq dritë në studimet albanologjike nën presion, sot ne as që mund ta marrim me mend se çfarë do të bënte në liri. Jeta e tij, pavarësisht se nuk la të shkruara kujtime e ndjesi, mund të mendohet si një luftë në heshtje me armiqtë që e dinte se e ndiqnin. Diku do kenë lënë gjurmë që ai i ka parë pa reaguari. I vetmi reagim që pati shkencëtari qe izolimi brenda vetes, nuk fliste më, nuk kumtonte më, nuk bisedonte më. Ai i shpëtoi burgut, por u ngujua në një hapësirë të kontrolluar, duke e ditur se burg qe dhe ky.

Larg prej dy skenave, larg prej zyrës së tij dhe shtëpisë se verdhë dykatëshe ku ai kishte gruan dhe vajzën, ruhej ende një tufë me raporte të Sigurimit të Shtetit mbi të cilën shënohej “Dosja Formulare, nr.2383”. Ajo qe e hapur deri gjashtë muaj pas ndarjes nga jeta të profesor Çabejt duke mbajtur në të, jetën e tij të tkurrur dhe emrin e madh të autorit të dhjetra studimeve.

Inxhinieri i urave nën survejim

Ai lë të kuptohet se e ka ndjerë gjithnjë atmosferën mbytëse në të cilën jetonte. Ndërsa pjesa e parë e jetës e kaluar në Europë përgatiti një njeri të lirë, pjesa e dytë, ia tkurri liritë dhe inxhinieri e dinte që jetonte mes mekanizmash frike.

E lartë dhe me harqe mbi lumin Mat, në mes dy kodrinave që ndajnë dy qytete, në zhargon ajo njihet me emrin e mbretit, si ura e Zogut. Është ende një prej urave më të bukura në Shqipëri, për ç'arsye është vënë në mbrojtje si monument kulture. Ka qenë viti 1926 kur një djalosh i ardhur nga jashtë u bë pjesë e grupit të punës të firmës Italiane "Mezzarana" për ngritjen e saj.

Gjovalini atë kohë që i ri, me diplomë austriake për Inxhinieri Civile, biri i një tregtari shkodran që i kish marrë mësimet e para në Kolegjin Saverian, e që ëndërronte për veten, një të ardhme të ndritur. Kish lënë pas një fëmijëri të vështirë, i ati e kish lënë të vogël dhe nëna Tereze e kish rritur e vetme në qytetin ku luftrat e sulmet s'kishin të pushuar. Mandej kishte fituar bursë nga austro-hungarezët që atë kohë kishin nën patronazh Shkodrën dhe kish shkuar atje vocërrak, për t'u kthyer zotëri.

Tanimë i rritur, pat ardhur në atdhe dhe punonte për Ministrinë e Punëve Botore. Fliste gjermanisht, rusisht, italisht e frëngjisht, e jetonte me vrullin e pasionin e kohës, kur të punoje për vendin tënd ishte krenari, sepse po ndërtoje Shqipërinë e lirë nga robëria pesëshekullore osmane. I gjatë, shpatullgjërë, me flokët pis të zinj dhe me portretin ku shkriheshin karakteri i malësorit me djaloshin e normave vjeneze ku pat kaluar moshën delikate, ai ndiqte punimet nga afër me shikimin e hedhur lart nga kambana e kishës mesjetare të Shën Barbarës.

Të vënë para madhështisë së urës, sa herë kalojmë harrojmë të pyesim se kush e ndërtoi a kush e pa për herë të parë të ngrihej për të lidhur dy brigje. Shpesh ne harrojmë të pyesim për historinë e atij që e vëzhgonte për javë e muaj të tërë, gur pas guri e çelik pas çeliku. Dhe vonë mësojmë se dikur në këmbët e asaj ure pat qëndruar ing. Gjovalin Gjadri. Më vonë historinë e tij të ndritshme e prapë kaq të trishtë.



REPUBLICA POPOLARE E SOCIALISTA

Ministero della Giustizia

Ministero della Pubblica Istruzione

Ministero della Sanità

Ministero dell'Economia

Ministero degli Affari Esteri

Ministero dell'Interno

Ministero della Difesa

Ministero della Marina

Ministero dell'Aeronautica

Ministero dell'Aviazione

Ministero dell'Industria

Ministero dell'Energia

Ministero dell'Acqua

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Ministero dell'Ambiente

Ministero dell'Urbanistica

Dosia Formulare

5072

ARTICOLI:
Il primo articolo parla di un nuovo progetto di legge che prevede l'abolizione della pena di morte. Il secondo articolo tratta di un nuovo accordo commerciale tra l'Italia e un paese straniero. Il terzo articolo parla di un nuovo progetto di legge che prevede l'abolizione della pena di morte. Il quarto articolo tratta di un nuovo accordo commerciale tra l'Italia e un paese straniero. Il quinto articolo parla di un nuovo progetto di legge che prevede l'abolizione della pena di morte. Il sesto articolo tratta di un nuovo accordo commerciale tra l'Italia e un paese straniero. Il settimo articolo parla di un nuovo progetto di legge che prevede l'abolizione della pena di morte. L'ottavo articolo tratta di un nuovo accordo commerciale tra l'Italia e un paese straniero. Il nono articolo parla di un nuovo progetto di legge che prevede l'abolizione della pena di morte. Il decimo articolo tratta di un nuovo accordo commerciale tra l'Italia e un paese straniero.

Karriera e Gjovalinit niste me një detyrë që njëherësh e konsolidonte emrin e tij, ai mbante pozicionin e inxhinierit kontrollues në Urën e Matit. Një vit më vonë, do të udhëtonte drejt Moskës, deri më 1932 ku punoi si inxhinier projektues në Institutin e Projektimit të Urave "Mostovoi Byro" në Bashkimin Sovjetik. Në kthimin e dytë, rifillon punë në Ministrinë e Punëve Botore. Është projektues e drejtues në sektorin e urave dhe ndërtimeve dhe punon në këtë

në Moskë, në vizitat e herëpashershme në Tiranë ai ishte njohur me Zejnep Toptanin. Veç shkaqëve shëndetësore, duhet të ketë qenë edhe kjo, një prej arsyeve që ai la Moskën për t'u kthyer në atdhe. Një vajzë e bukur, që kishte studiuar në Vjenë e që vinte nga një prej familjeve të mëdha shqiptare, të lidhur me mbretin Zog, por me rrënjë deri te princërit e mesjetës. Gjovalini dhe Zejnepi duheshin, ai ishte i suksesshëm në punë, kishte në duar projekte madhore



Gjovalin Gjadri dhe gruaja e tij (1935)

Gjovalin Gjadri gjatë të '50ve

Tashmë komunizmi ka triumfuar dhe po instalon regjimin e tij në Qeverinë Shqiptare. Gjadri sheh se si vendimet merreshin nën ndikimin e komunistëve jugosllavë.

kohë me urat e njohura që qëndrojnë ende sot: ajo e Lanës në bulevardin e madh të Tiranës më 1932, Ura e Bunës në Shkodër më 1934, Ura e Zaranikës në Elbasan më 1934 dhe ajo e Gjanicës në Fier më 1940. Njëherësh ka nisur edhe botimin e artikujve e studimeve jashtë vendit.


Vitet 1930 qenë me gjasë më të bukurat në jetën e tij, jo vetëm për arsye profesionale. Oë kur ishte

dhe ishte i dashuruar me një prej zonjushave më të bukura të Tiranës. Babai i Zejnepit, kishte qenë ndër firmëtarët e deklaratës se Pavarësisë së Shqipërisë dhe njëhej për kohën si reformator. Por në mesin e një Tirane që ende luftonte mes Orientit e Oksidentit, Abdi Toptani, nuk mund të pranonte martesën e së bijës me një njëri që nuk i përkiste rangut të tij dhe as të pranonte për dhëndër një katolik, kur vetë kishte përfaqësuar myslimanët në Këshillin e Lartë.

Zejnepi ikën nga shtëpia e prindërve dhe martohet me inxhinierin shkodran pa marrë miratimin e familjes. Janë të rinj, të dashuruar dhe të lumtur edhe pse martesë e tyre nuk është bekuar prej parisë së qytetit. Lumturisë së tyre i shtohet edhe ardhja në jetë e një fëmije. Është djalë dhe e quajnë Egon. Janë 10 vite ku jetët e zonjës së bukur dhe zotërisë së pashëm marrin hov. Kur janë larg, këmbëjnë letra si të dashuruar, por dy ish studentët vjenezë ndajnë mes rrjeshtave edhe

më 15 gusht të vitit 1941. Tronditja është e madhe. Është 42 vjeç, i ve, baba i një fëmije dhe ka humbur dashurinë e jetës së tij, ka humbur gruan që e deshi shumë e me të cilën nuk mundi të shijojë më shumë se 10 vite. Për të, qenë aq pak.

E përjeton shumë keq. Në vitin e zisë, duke nisur tri javë pas ikjes së saj, ai shkruan në gjuhën gjermane një libër “Letra grues seme të vdekun” ku nxjerr mallin e mllëfin, dhimbjen e inatin, mërinë e lotët. Nën pseudonimin G.Maranaj, ai herë ia hedh fajin vetes, e herë luftës që u nuk i la të shkonin në Vjenë për kurim, herë tjetër e sheh fajin te familja e Zejnepit dhe shkon deri te të parët e saj që i hapën zemrën dhe derën armikut turk duke nënkuptuar konvertimin në besimin islam që për ta u bë shkak që të mos pranoheshin nga familja e saj. Libri i përkthyer në shqip vetëm më 2017 nga Ardian Ndreca, tregon dimensionin njerëzor të inxhinierit, dashurinë e tij pakufi, vetminë e pafund që i la humbja e Zejnepit dhe vendin bosh në zemrën e tij. Ai kurrë nuk u martua më, as u përfol për ndonjë lidhje dashurie. Ai kurrë nuk e zëvendësoi, zonjushën që njohu në mbrëmjet e Tiranës së 1930-ës.



Raport nga agjentët e sigurisë (1949)

I kalon mes dhimbjes vitet e luftës dhe kur vendi çlirohet është pothuaj indiferent. Partizanët kanë triumfuar dhe po instalojnë regjimin komunist, pavarësisht se cilat qenë idealet e tyre.

reflektime me natyrë filozofike mbi jetën, vdekjen, shoqërinë e kulturën. E ardhmja dukej premtuese, duhej vetëm të mbaronte lufta e sapo nisur.

Ai sheh se si vendimet merreshin nën ndikimin e komunistëve jugosllavë. Për shumë studiues, vendimmarrësit qenë jo shumë të përgatitur nga ana kulturore apo shkencore, por të etur për pushtet e mbi të gjitha të pamëshirshëm ndaj gjithkujt: të gatshëm të vritnin këdo dhe në çdo moment që të mund të mbanin pushtetin. Vetë Enver Hoxha kërkonte spastrim nga elementet kundërshtarë kur thoshte: “kritika e autokritika bolshevike... spastron njerëzit, spastron Partinë tonë, spastron pushtetin dhe vendin tonë nga ‘... pleshtat, spekuluesit, nga tartabiqet.- siç i quan Lenini njerëzit e këqinj që futen kontrabandë në radhët tona. Partia ju thotë juve t'i bëni sytë katër kudo.”

Por kur Shqipëria pushtohet, jeta e çiftit të ri, ndryshon përgjithnjë. Zejnepit i shfaqet tuberkulozi. Gjovalini bën të pamundurën ta mbajë në jetë dhe e dërgon për kurim në Itali. Pavarësisht dëshirës së saj e luftës së tij, ajo ndahet nga jeta në Romë

**“Zhveshja e drejtave, më kujton
përsëri kohët e hershme kur kam
kenë student në Austri, ku kam ndie
një mungesë, kam hekë një vuajtje
që nuk e kam ditë se çka është kanë,
por që tash e di se ka kenë vuajtja
e mungesës të Atdheut, që e kam
kërkue gjithmonë dhe nuk e kam
gjetë kurr, sa këtu në Shqipëri**

Gjadri sheh edhe që regjimi komunist, intelektualët që mund të mendonin ndryshe nga dogmat zyrtare, i shikonte si kërcënim për ngritjen dhe ruajtjen e pushtetit ndaj për shumë prej tyre nisën akuzat si sabotatorë, arrestimet, internimet, torturat e pushkatimet. E kupton çfarë po ndodh, i ka parë kolegët të eliminohen dhe duket se e ka ndjerë të nevojshme të saktësojë më 1945 mes të dhënave për veten se “Në kohën e okupacionit Italian nuk jam shkruar në Partin Fashiste, as në kohën e okupacionit Gjerman nuk kam bashkëpunuar me Gjermanin”. Atë vit i jepet Urdhëri i Punës me Dekret të Kuvendit Popullor se “Ndonse shëndet lig, Gjadri u hodh pa rezerva në ndërtimin e krejt urave të mëdha. Vuri krejt zotësin e tij teknike në shërbim të popullit”.

Por vlerësimi nuk e mbron nga Sigurimi i Shtetit që ka nisur survejimin e tij. Edhe pse punon në rindërtimin e vendit, ai mbahet nën kontroll. Në dosjen pranë Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, trajtohet herë si figurë e pastër e herë me hije dyshimi. Një raport i 1949-ës fillon me

fjalët “për kategorizimin e aktivitetit kundërshtar të Gjovalin Gjadrit”. Hidhen dyshime për të kur vërehet se “ka qëndruar në Moskë... largimi i tij nga Bashkimi Sovjetik nuk dihet përse, meqëse ka kryer universitetin në Austri, dyshohet të jetë kenë agjent i kontrollit austro-gjerman”.

Ishin kohët kur të shkolluarit jashtë vendit shiheshin si agjentë të huaj. Në dosje shënohen edhe ‘cene’ të tjera për inxhinierin. Për ta Gjadri ka qenë i privilegjuar në kohën e mbretit, i ka shërbyer fashizmit, ka pasur simpati për Ballin Kombëtar e Legalitetin që qenë kundërshtarë politikë të komunistëve, nuk ka bërë rezistencë dhe ka qenë indiferent. Krahas këtyre interpretimeve shënohet se “ka shikuar gjithmonë lekun dhe interesin e tij personal” cilësim që për kohën ishte e rëndë.

Jeta e tij shënoi arritje të mëdha profesionale. Në fondin e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit ruhen projekte të mbi 75 veprave inxhinierike të tij të ndërtuara

nëpër Shqipëri ndërsa jep mësim në Universitetin e Tiranës, është anëtar i Institutit e Studimeve dhe boton studime voluminoze. Kur punonte me veprën e tij më madhore “Shkenca e Konstruksioneve” me 550 faqe, Gjadri i shkruan nën/Kryeministrit Spiro Koleka një promemorie, ku mes të tjerash, për shkak të shëndetit të dobët, kërkon 3 orë në ditë liri veprimi, brenda orarit zyrtar dhe pakësim të çështjeve formale dhe administrative që të mund ta përfundojë librin.

Letra nxjerr në pah guximin e tij për të kërkuar një liri të kushtëzuar kur thotë: “Nuk qëndron çështja mbas mendimit t’em te mekaniciteti i permanencës ma pak a ma shumë në zyrë, por te trajtimi akademik....Kam informata se, në Bashkimin Sovjetik, ata që merren me shkrime librash, shkruajnë vetëm libra dhe nuk merren me asnjë punë tjetër”.

Megjithë sa më lart, nga një vështrimi i detajuar që i kanë bërë dosjes së tij Albert Nikolla e Joana Doda për studimin mbi të cilin bazohet ky artikull, inxhinier Gjadri kishte marrëdhënie të ftohtë me regjimin. Ai e sheh regjimin si punëdhënës, madje më 20 korrik të 1949-ës dosja e tij, tregon se ka pasur debat për pagën. Gjadri ka kërkuar barazim të pagës së tij me të mjekëve, siç e përcaktonte ligji i punës dhe siç i kishin premtuar ministrat. Analiza e studiuesve Nikolla e Doda ka arritur në përfundimin se Gjadri është cilësuar gjithnjë si armik, por regjimi kishte nevojë për përgatitjen e tij e vlerësuar atë kohë edhe jashtë vendit.

Ka rreth 30 raporte për aktivitetin e tij gjatë viteve 1946-1954, përmes të cilave raportohen biseda, takime e kërkesa. Raportet e dhëna në kushte anonimati merren më shumë me thashetheme se me çështje të faktuara për inxhinierin sikundër, hiperbolizohet ‘gabimi’ i të përndjekurit, bazuar në opinione si ky raport i vitit 1951 ku shkruhet “del se është menefregist në punë... Megjithëse nuk kemi fakte konkrete në duar, si opinion unë e them me siguri se është një fashist i fëlliqur mbasi megjithëse shpërblehet rreth 10.800 Lek në muaj është i

pakënaqur për shpërblimin që merr. Në një mbledhje ose diskutim politik si informacion politik etj, nuk i pret mirë, dhe këto i shpreh me fjalë indirekte”.

Përtej ftohtësisë së portretit dhe sjelljes, ai lë të kuptohet se e ka ndjerë gjithnjë atmosferën mbytëse në të cilën jetonte. Ndërsa pjesa e parë e jetës e kaluar në Europë (shkollë e mesme dhe e lartë) përgatiti një njeri të lirë, pjesa e dytë, ia tkurri liritë. E dinte që jetonte mes mekanizmash frike. Në mënyrë pothuaj naive, ai kishte bërë një përpjekje të fundit për të ikur nga vendi. E kërkonte në rrugë zyrtare largimin përmes një letre drejtuar pushtetit më 24 mars 1947.

“Shveshja e drejtave, më kujton përsëri kohët e hershme kur kam kenë student në Austri, ku kam ndie një mungesë, kam hekë një vuajtje që nuk e kam ditë se çka është kanë, por që tash e di se ka kenë vuajtja e mungesës të Atdheut, që e kam kërkuar gjithmonë dhe nuk e kam gjetë kurr, sa këtu në Shqipëri ... por në degradimin tem kam bindjen me të drejtat dhe pretendimet e mija këtu në Shqipëri, janë pa të realizueshme... dëshiroj ta le këtë Shqipëri. Unë kam një nanë dhe një motër në Austri, që vujn ekonomikisht simbas lajmeve që kam marr... I lutem ministris me më shkarkue nga çdo detyrë dhe me ndërmjetësu ku duhet për lëshimin e pashaportës që mund të shkoj në Austri”.

Kërkesa nuk iu miratua, madje u cilësua kompromentuese por së paku nuk rezultoi që u bë shkak ta dënonin. Ai nuk i pa më kurrë nënën e motrën. Survejsimi iu hoq më 1956 dhe i thinjur, u nda nga jeta në Tiranë në moshën 75-vjeçare duke lënë pas vetëm një dashuri, Egonin, birin e tij me Zejnepin. Kishte pyetur veten gjatë nëse do ta shihte më të shoqen, madje kjo ishte frika e tij më e madhe pasi e humbi. Mbase për këtë edhe nuk e pati frikë vdekjen dhe rrojti i lirë sa mundi.

Nën urat e tij lumenjtë kalojnë vrullshëm, por ato janë ende në këmbë dhe ndodh që dikush pëshpërit: „Këtë e ka ndërtuar inxhinier Gjadri”.

“Mendimet nuk mund të burgosen”

“Kanë prangosur trupin tim, por nuk kanë mundur të prangosin mendimin tim. Dhe – gjë vërtet e mrekullueshme – kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë...”

Vloçisht, 1948. Tri baraka të mbuluara me mushama, vende-vende të shpuara strehojnë nga 1300 deri në 1600 të burgosur. Brenda tyre vjen erë e rëndë. Krevatet kanë vetëm nga tri dërrasa. Është korrik kur një djalosh 28-vjeçar u bashkohet aty të dënuarve që kanë tre muaj në kamp. Quhet Arshi Pipa dhe nuk njih asnjë. Prej mundimeve e urisë, portretet e tyre i kanë humbur tiparet. Të dënuarit, nuk kanë mundësi të lahen a të pastrohen, ka për të gjithë vetëm një pus, ndërsa ujë të pijshëm, fare pak. Janë bashkë të dënuarit politikë e ata për krime ordinere. Këta të fundit mbahen më mirë se intelektualët, sepse cilësohen proletarë. Ka shumë raste vjedhjes dhe dënohen ata që ankohen, më shumë se sa ata që vjedhin. Ushqimi në kamp është i pakët, të burgosurit punojnë larg, dhe kur shohin ara me misër vrapojnë të marrin ndonjë kalli e ta hanë edhe pse rojet i godasin me shkelma kokës.

Nuk kanë këpucë e çizme, shpesh ecin zbathur, shkojnë larg për të hapur kanale, ndaj këmbët u enjten dhe shpesh, vdesin shpejt.

Arshi Pipa i mban këto shënime fshehurazi, në letra cigareje. Jeta e tij është thyer në mes dhe ai e dokumenton atë. Kishte qenë profesor, filozof, kritik, poet, por kohët e lirisë dhe vetë fëmijëria tashmë janë të largëta.

Kishte lindur në një familje të mirë. I ati, Mustafai nga Libohova ishte gjyqtar i shkolluar në Stamboll, ishte njohur e martuar me Hatixhenë dhe qenë vendosur në qytetin e saj në Shkodër. Kishin dy djem e katër vajza. Arshiun e patën dërguar të merrte mësimet e para në kolegjin e Jezuitëve, ku përvetësoi herët greqishten e vjetër e latinishten, gjuhët që e shoqëruan gjithë jetën siç na dëshmojnë sot përkthimet e lëna në dorëshkrim. Shumë i lidhur me familjen e tij të madhe, nga të gjithë veçonte të



vëllanë, Muzaferin, e ndërsa ai kishte nisur studimet për jurisprudencë në Padova të Italisë, Arshiu më 1938, shkoi në Firence për Letërsi e Filozofi. I rregullt në shkollë e i dhënë pas mësimëve, rioshi e shfrytëzonte edhe kohën e lirë për të lexuar. “Nuk kemi ardhë këtu për ahengje e dafrungë, por për më studjue. Dhe më parë se gjithshka asht detyra. E detyra jonë asht studimi e mbarimi i universitetit!”, u thoshte ai miqve kur e ftonin të dilte.

dhe të ndërtojë profilin e tij intelektual. Punon një vit mësues në Gjimnazin e Tiranës, përgatit tezën e diplomës për filozofin frëng, Henri Bergson, punon në gjimnazin e Shkodrës dhe më pas vendoset me gjithë familjen në Tiranë.

Në kryeqytet, më 1944 Pipa themelon revistën “Kritika” që doli katër numra me synim nxitjen e kritikës letrare në Shqipëri, pasi është konsultuar



**“Ata më kyçën mua në burg
për të më bërë të vuaj.
Por unë nuk mbaj asnjë
qëndrim kundër tyre...
në fakt, ju jam sinqerisht
mirënjohës”**

Arshi Pipa ishte në vitin e dytë të studimeve, kur nisi lufta dhe Shqipëria u pushtua. Më 1941 kur kthehej, vendi kontrollohej nga fashistët dhe grupet e rezistencës qenë ngritur. I vëllai ishte arrestuar sepse pat kundërshtuar pushtimin dhe ishte internuar në ishullin famëkeq Ventotene më 1940 si shumë shqiptarë të tjerë. Në këto kohë të vështira për familjen, ai zgjedh të rrijë me të, i tërhequr nga lufta

me dietarin Aleks Buda siç del nga një letër e 23 marsit që ruhet në arkivin e familjes Buda. “Gjithsesi nuk besoj t’ia kem dalë plotësisht”, i shkruan profesorit, “por mendoj se në numrin i dytë do të jetë më i pasur dhe i ndryshëm”.

Internimi i vëllait, ishte vetëm një arsye pse Pipa nuk u angazhua në Lëvizjen Nacionalçlirimtare,

kundërshtimi i modelit totalitar dhe filozofisë marksiste ishte arsyeja tjetër. "Jam rritur në një familje që mund të konsiderohet demokratike, me urrejtje për diktaturën e çfardo tipi qoftë ajo", do të shprehej ai në një intervistë të pas '90-ës ku tregonte se i kishte lexuar Marks, Lenin, Gramshin, Stalinin dhe e njihnte ideologjinë e tyre. Djaloshi i diplomuar në filozofi, i dhënë pas Spinozës e Kantit, i cilësonte të papërfillshëm ideologët marksistë. Madje, për Stalinin mendonte se që pa ndonjë farë niveli, ndaj imponimi i stalinizmit në Shqipëri e mbante larg nga lufta e udhëheqësit e saj. E ndonëse i ishte propozuar të bëhej pjesë e lëvizjes nacionalçlirimtare, nuk pranoi.

Në mbarim të luftës, Arshi Pipa ishte profesor e pjesë e Institutit të Studimeve, kur Partia Komuniste bëhet vendimmarrëse dhe nis goditjen e kundërshtarëve. Çështja e parë e bujshme ishte i famshmi "Gjyq i Deputetëve" ku u dënuan politikanë elite që kërkonin vendosjen e një sistemi demokratik qeverisjeje. Avokat i tyre ishte caktuar Muzafer Pipa, që për shkak të padrejtësive që po bëheshin në gjyq, pati përplasje me gjykatësin. Vëllai i Arshiut më tej mbrojti në gjyq edhe klerikët katolikë, çka shënoi fundin e tij.

Është viti 1946 dhe vetë Arshi Pipa është vënë në survejim, ai nuk e di dhe e kundërshton regjimin në disa mënyra. Një ligjëratë për Migjenin, poetin e mjerimit, një koment mbi poezinë e Faustit "Kënga e Plebishtit", janë cilësuar si akte rebelimi dhe ai ulet në detyrë e dërgohet në Durrës si mësues, ku çdo lëvizje e Arshiut i raportohet Sigurimit të Shtetit nga një student i tij, i cili madje e provokon duke e pyetur për Mayakovskin dhe për Stalinin, për të cilët Arshi ulet pa vlerësim.

Kulmi shënohet në një mbrëmje letrare, ku një prej recituesve flet për ndërtime të një fabrike. "Do e ndërtojme me slogane", thotë me ironi një djalë në të djathtë të tij, Arshi qesh në shenjë

aprovimi dhe teksa një poezi patetike interpretohej, zhvillohet një dialog parodizues buzëqeshjesh dhe ironish. Në fund ata përshëndeten, djaloshi ikën dhe vetëm më pas, Arshi mëson se e kish përqeshur sistemin me Nako Spiron, një prej drejtuesve komunistë. "Rebelimi" i tij dhe qëndrimi i të vëllait në gjyqin kundër deputetëve bëjnë që Arshi të arrestohet në prill të 1946-ës.

E akuzojnë për veprimtari kundër pushtetit me grupe tradhtare dhe në nëntor e dënojnë me dy vjet burg në Durrës. Sipas një studimi të Andi Pinarit e Indrit Qehajaj, mbi të cilin bazohet ky artikull, dënimi ishte arbitrar, çka pranohet më vonë edhe nga hetuesit. Por, ndërsa ai vuante dënimin, hetimi për të vijon dhe një dokument i 5 dhjetorit 1947 e cilëson dënimin e parë minimal, me argumentin se autoritetet nuk kanë pasur prova të mjaftueshme. Me pretendimin se ende nuk ishte zbuluar thellësisht organizata tradhtare-sabotore e deputetëve ku ai bënte pjesë, duke i shtuar akuzës edhe vëlla Myzaferin si tradhtar dhe armik i popullit, bëhet një proces i dytë gjyqësor.

Ka një lum akuzash për të: pjesë e organizatës social demokrate, i lidhur me klerikët dhe partitë tradhtare të Ballit Kombëtar dhe Lëvizjes së Legalitetit, kundërshtar i reformave e sabotator në sektorin e librit shkollor, propagandues i një ndërhyrje të armatosur nga anglo-amerikanët që do rrëzonin pushtetin, drejtues revistash fashiste. Akuzohet që bënte mbledhje të rregullta në Liceun e Tiranës, se i mblidhte studentët në shtëpinë e tij për t'u bërë propagandë kundër pushtetit, që u thoshte se pushteti ishte shtypës e terrorist, se reformat po shkatërrojnë vendin dhe po varfërojnë popullin e se në drejtim janë vendosur njerëz të paftë.

Pipa nuk i pranon akuzat. Mohon të ketë pasur dijeni për një organizatë kundër pushtetit e përgënjeshtrore deklarimet e dëshmitarëve. "Pakënaqësitë e mia ndaj pushtetit popullor unë

i kam shprehur dhe janë të njohura”, shprehet Arshiu dhe kërkon ballafaqim, pasi ndonjë prej dëshmitarëve as e njih fare, e me disa të tjerë, ka folur vetëm për çështje letrare e jo politike. Thotë se studentëve u ka dhënë mësim privat dhe mbase nuk i kanë kuptuar fjalët e tij.

Për Arshi Pipën kërkohej dënim maksimal, por ai nuk i pranonte krimet për të cilat akuzohet. Hetuesi e kërcënon se do të përfundojë si i vëllai nëse nuk dëshmon çfarë i kërkohet. Arshiu e merr vesh në këtë mënyrë vdekjen e Muzaferit tre muaj më pas. Ishte arrestuar dhe kishte humbur jetën në tortura. Për të mbuluar krimin, e kishin hedhur nga dritaret e ndërtesës ku zhvilloheshin hetimet në Shkodër dhe vdekjen e kishin mbuluar si tentativë arratisjeje. Të motrat nuk kishin mundur t’ia thoshin sepse e dinin sa e donte Arshiu të vëllanë dhe ishin të vetëdijshme për shëndetin e dobët të tij. Më 20 dhjetor 1947 Arshi Pipa ridënohet nga Gjykata me 20 vite burg.

Shkruan një elegji për të vëllanë, ku e pranonte vdekjen e tij dhe betohet të gjejë forcë. Në Vloçisht, kushtet e këqija të burgut i vuan më shumë për shkak të inflacionit në mushkëri. Sheh se fshatarët e dënuar shihen me më pak përçmim se intelektualë si ai. Ndaj shpesh, intelektualët vishen si fshatarë për t’i shpëtuar dhunës. Kampi i Vloçishtit i duket një kamp shfarosjeje!

Përfiton nga një amnisti e Enver Hoxhës më 1949 dhe i ulen 10 vite burg. Pas një viti në kamp, sëmundja i rëndohet dhe shtrohet në spitalin e burgut në Durrës(1950). E dërgojnë në burgun e Gjirokastrës(1952), më pas në burgun e Tiranës. Sëmuret sërish. Shtrohet sërish në spitalin e burgut. Kohë më vonë e çojnë në burgun e Burrelit, ndër më të tmerrshmit e kohës. Aty, ka vetëm një pus, por të burgosurit nuk kanë me se ta marrin ujin, nuk u jepet enë, as kovë, as litar. Përdorin ç’të munden

për ta nxjerrë, por është i ndotur. Shpesh herë del me krimba. Të burgosurit sëmuren, qindra prej tyre gjejnë vdekjen. Shtrirë në një dyshek të shtruar në çimento, në një fletore ku shihej portreti i Stalinit, shkruan një vepër filozofike. “A do të kisha imagjinuar ndonjëherë që njeriu, kjo qenie që Zoti e krijoi sipas shëmbëlltyrës së vet, mund të jetë kaq afër kafshës? Tashti po e kuptoja se ç’domethënie kishin ato hyjni pagane, gjysmë njeri e gjysmë kafshë, si centaurët e sirenat! Në burg kam njohur gjithë poshtërsinë e njeriut, gjithçka që është trashëgim shtazor tek ai, nga egoizmi i egër që arrin të urojë vdekjen e shokut për t’i vjedhur bukën, te frika e marrë shtazore që errëson jo vetëm arsyen, por deri edhe ndjenjat”. E shkruan në gjuhën italiane “Skicën e një konceptimi mbi jetën plotësuar me mbigjeniu” prej ku janë shkëputur fjalitë, sepse gardianët nuk do e kuptonin gjuhën, nëse arrinin t’ia gjenin.

I dobët dhe i sëmurë, arrin të dalë i gjallë prej aty në prill të 1956-ës. Ka ruajtur shënimet e 10 viteve të veta në burgje në letra cigaresh. I ka nxjerrë nga burgu të fshehura në rrobat e palara. Ndërsa veprën e filozofike e nxjerr të fshehur në një dyshek të vjetër që rojave nuk u shkon në mendje ta kontrollojnë.

Rreket të shijojë lirinë me të ëmën e motrat. Mendon se vuajtjet mbaruan, por e kupton që nuk është krejt e vërtetë. Si ish i burgosur ka vështirësi të gjejë punë. Të tjerëve u jepeshin punë fizike, por ai është i dobët e i pafuqi. Pas shumë mundimesh e caktojnë mësues në një shkollë shtatë vjeçare në Shkodër, por kjo nuk e kënaqte.

Kërkon ta lërë punën me pretekstin se është i sëmurë. Sistemi veçse bëhet më i fortë dhe ai vendos të arratiset, bashkë me një nga motrat. Në një libër të studiuesit Uran Kalakulla, kushtuar Pipës, shënohet se ai dhe motër Fehimeja, u ndihmuan nga një fshatar që kishte shtëpinë pranë

kufirit. Arshiu e kaloi lumin e Bunës me not e matanë bregut e priti motra. Shkojnë në Muriqan, arrijnë të kalojnë kufirin shqiptar dhe paraqiten pranë postës jugosllave, ku qëndrojnë disa kohë në hetuesi në Tivar. Kanë fat dhe jugosllavët nuk i kthejnë mbrapsht. Lirohen dhe i drejtohen Sarajevës ku ndodhet i fejuari i Fehimes me familjen e tij. Para se të ikin, kanë marrë me vete kujtimet: letrat e cigareve me shënime e motra i kish qepur nëpër rrobat e saj.

Gjatë muajve shtator – nëntor 1957 kur janë në Sarajevë i kanë renditur fletët. Arshi Pipa ëndërron Perëndimin, ndaj ikën së pari në Romë dhe më pas në Amerikë. Atje, pasi mëson gjuhën angleze nis të ngjisë shkallët e karrierës në universitet. Si fillim jep lëndën e filozofisë dhe filozofinë e fesë e krishterë. Në një dokumentar të Televizionit Publik Shqiptar në vitet '90, Arshiu shprehet se njohuritë e tij për sa i përket fesë ishin të pakta, vetëm disa gjëra që mbante mend nga kolegji i Jezuitëve. Arshiu u bë një pedagog mysliman që jepte filozofi të krishterë.

Kur është në Detroit letrat e cigareve i përgatit dhe i bën libër që botohet në Romë në vitin 1959. E quan "Libri i Burgut" dhe tregon në të vuajtjet dhe torturat. Mundi të rikthehet në atdhe 30 vite më vonë. E megjithatë vetëm pas vdekjes së tij, motra tjetër, Nedreti, përkthen nga italishtja dhe boton veprën e tij filozofike, për të njohur më mirë të vëllanë me të cilin jetoi aq pak, sepse ai u arratis e ajo e shkoi jetën në internime.

Ai ia doli të bëhej i fortë dhe ia doli të mbetej njeri. Nëse do të pyetej se çfarë i bëri komunizmi Arshi Pipës, përgjigjen do ta gjenim te vepra e tij filozofike të cilën e shkroi në burg. "Kanë prangosur trupin tim, por nuk kanë mundur të prangosin mendimin tim. Dhe – gjë vërtet e mrekullueshme – kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë,

Pipa betohet të gjejë forcë për të pranuar vdekjen e vëllait të tij dhe shkruan një elegji për të në burg



atëherë mendimi ka fituar lirinë... Më kanë mbyllur në këtë burg që të vuaj. Unë nuk u mbaj mëri atyre që më kanë bërë të vuaj, madje i falënderoj, dhe sinqerisht. Ka të drejtë të mallkojë vuajtjen ai që shtypet nga ajo. Por, ai që e mund, do të duhej ta bekonte. Ndërsa njëra degjeneron në vuajtje, tjetra ripërtërihet. Poshtë ajo të çon te krimbi, lart te hyjnia..."

Mes shkencës e politikës

Faktet tregojnë për një pozicion të dyzuar mes shkencës dhe politikës, por ai gjeti hapësirën e lirisë së brendshme ku mund të ndiqte interesin e tij intelektual pa ndërhyrjen e qeverisë.

Portreti i gjerë i një burri me syze, në dukje babaxhan, me një buzëqeshje të ndrojtur zë vend të dukshëm në sallën kryesore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Shikimi, sa pyetës dhe depërtues përtej qelqeve, është i palexueshëm. I atribuohet atij shumëçka që shkenca, biblioteka dhe historia kanë arritur në vitet që ai drejtonte institucionet kombëtare. Aleks Buda kishte mbërritur të ishte drejtor i Bibliotekës Kombëtare e kryetar i Akademisë së Shkencave në kohë të vështira; kur shkenca dhe shkencëtarët tëurvejuar e të diktuar nga regjimi, patën humbur edhe jetën, në mos lirinë. Pas shfrytëzimit të dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit, atyre të ish Sigurimit dhe letrave origjinale me shënime të vëna në dispozicion nga e bija Tatjana Haxhimihali, doli që në emrin e tij nuk ka asnjë dosje personale, ndonëse përmendet në dosjet e kolegëve që ishin nën mbikqyrje. Ndaj historia e Budës, është

një histori mbijetese në kohët kur jeta vlente më pak se partia. Andi Pinari mbi studimin e të cilit është bazuar ky artikull, e cilëson atë një dijetar evropian në totalitarizmin shqiptar. Ai qe, një ndër personazhet më me autoritet të kohës e një ndër personazhet që ia dolën të gëzojnë lirinë, për aq sa mund të gëzohej ajo, në shtetin e izoluar shqiptar.

Historia e atij portreti në dukje të paqtë, nis në vitin 1910, kur ai lind në një familje intelektuale. Ishte nipi i një gjyshi doktor të shkolluar në Itali e djali i një farmacisti të shkolluar në Greqi. Farmacia e familjes Buda në qendër të Elbasanit, zinte vend deri në një artikull austriak të 1913-ës. I ati, Taq Buda kishte kontribuar gjatë sundimit osman për Rilindjen Kombëtare, kishte ndihmuar me të holla Shkollën Normale të Elbasanit dhe ishte pjesëmarrës në Kongresin e Manastirit ku vendosej fati i gjuhës shqipe, mandej qe bërë deputet.

Nga një familje e tillë, që krejt e natyrshme që Buda dërgohej të shkollohej në Itali e në Grac të Austrisë. Kur është në gjimnazin e Salzburgut mëson latinishten dhe greqishten e vjetër, ndërsa në Universitetin e Vjenës me kërkesë të të atit regjistrohet në degën e farmacisë. Pas vetëm një semestri ndërron degë e kalon në Fakultetin e Filozofisë, ku studion Histori dhe Letërsi. Profesorë të tij janë albanologët e njohur Karl Patsch dhe Norbert Jokl, me të cilët krijon raporte miqësore ndërsa shokët e tij në Vjenë janë ata që më vonë në Shqipëri bëhen autoritete në fusha të ndryshme, si Skënder Luarasi, Krist Maloki, Eqerem Çabej, Lasgush Poradeci etj.

Kur do të shkruante kujtimet, Buda i cilësonte 18 vitet e jetuara në Austri si më të qenësishmet në formimin e vet. Dhe në fakt qenë të tilla. Qeveria shqiptare e kohës i mbikëqyrte studentët jashtë vendit, sidomos ata të Vjenës, për të qenë e informuar mbi lëvizjet e tyre në qytetin ku rrinte Fan Noli, kundërshtari politik i mbretit Zog. Buda e dinte se bashkë me të vëllanë, Mihalin, prej konsullit shqiptar atje cilësoheshin të dyshimtë ngase shoqëroheshin me Skënder Luarasin, të cilit shteti i kishte hequr bursën për arsye politike. Qe në këtë kohë, një vit para se Shqipëria të pushtohej, që një takim në Vjenë do të shënjojte e mbase ndryshonte jetën e 28-vjeçarit.

Në kryeqytetin austriak mbërrin Ali Kelmendi, një prej veprimtarëve të parë komunistë shqiptarë. Strehohet në dhomën e studentit të historisë për disa javë. Mikpritja e Kelmendit do ta bënte policinë e Vjenës të kontrollonte dhomën e Budës. “Këto elementë nga jeta Prof. Budës tregojnë për një prirje politike drejt së majtës në vitet e studimeve duke pasur si model social-demokracinë evropiane, ndonëse kishte simpati për marksizmin për shkak të polarizimit të skajshëm që diktonte koha”, vëren studiuesi Pinari.

Pas këtij incidenti, Buda diplomohet dhe merret me gjuhësi me ndihmën e albanologut Jokli, e kur nis

përndjekja naziste ndaj profesorit, studenti kthehet në Shqipëri. Atdheu e pret me pranga. Policia e merr në pyetje për lidhjet me Ali Kelmendin e ata që përhapnin ide bolshevike. Ai qëndron në burgun e Elbasanit për 20 ditë. Por nuk ndalet.

Budën e gjejmë si një të ri idealist ta shprehë rezistencën kundër pushtimit në forma të ndryshme. Merr pjesë në demonstratën e 7 prillit të 1939-ës, si profesor letërsie në gjimnazin e Tiranës ndjek

Prof. Buda arriti të përqendrohej gjithnjë e më tepër në çështjet e shkencës duke gjetur hapësirën e tij të lirisë së brendshme në atë kohë të vështirë. Ai e ka ditur mirë cilat ishin pasojat nëse rebelohej.

aktivitetet me sfond politik, vë në skenë “Vilhem Telin” me nxënësit që këndojnë këngën patriotike “Për Mëmëdhenë”. Kur shfaqja pezullohet prof. Buda thirret në Ministrinë e Arsimit për të dhënë llogari, mandej e transferojnë në Liceun e Korçës. Teksa është atje, autoritetet i kontrollojnë shtëpinë dhe e shoqërojnë drejt burgut të Tiranës. Tanimë është në

të 30-at. Pyetet për qëndrimin e tij, për pjesëmarrjen në manifestimin e 28 nëntorit 1939 dhe pak ditë më pas lirohet nga burgu pa ndonjë akuzë e rikthehet në Korçë. Verën e ardhshme e rekrutojnë me forcë në ushtrinë italiane dhe çojnë në Itali bashkë me shumë mësues të tjerë. Buda arrin t'u shpëtojë. Ka siguruar një raport mjekësor. Kthehet në Korçë për të dhënë mësim dhe 6 muaj më pas e gjejmë në Universitetin e Padovës, ku ndjek kurse kualifikimi e studion linguistikë ballkanike. Jetës së vullshme



duket se i vihet kufi, kur detyrohet të kthehet pas një viti. I është arrestuar e ëma, për shkak të të vëllait që është në njësitin guerril të Elbasanit. Arrin ta lirojë nënën, e rinis punë në Gjymnazin e Tiranës. Është kjo koha kur ai lidhet përfundimisht me Lëvizjen duke hyrë në Këshillin Nacionalçlirimtar ilegal të Tiranës, mbledhjet e të cilit mbahen në shtëpinë e tij.

Pavarësisht angazhimit politik, ai kishte krijuar reputacion mes studiuesve shqiptarë, ndaj gjejmë sot letërkëmbime të tijat me personazhe si Arshi Pipa a At Zef Pllumi, që ishin kundër ideve politike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare ku Buda ishte pjesë. Shkruanin gjithsesi për çështje historike e letrare. "Formimi intelektual dhe patriotik si edhe ndikimi i familjes së tij me emër në qytet, bëri që ai të shndërrohet në një përfaqësues të rëndësishëm të intelektualëve në luftën kundër pushtuesve. Në shtator 1944 u zgjodh nënkryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar të qarkut të Elbasanit. Në fund është në Kongresin e Beratit dhe thirret për të punuar në Ministrinë e Kulturës", shënon Pinari.

Ministri Sejfulla Malëshova e emëron më 1945 në krye të Bibliotekës Kombëtare, atëkohë me vetëm 15000 vëllime. I jepen në dorëzim librat e Mit'hat Frashërit, intelektualit të Ballit Kombëtar që kishte ikur në Itali. Biblioteka do të pasurohej, por kryesisht prej konfiskimit të bibliotekave private të personaliteteve të kohës, ndaj më 1947 fondi i numëronte 100.000 vëllime. Ndonëse mban një detyrë të lartë, ai nuk harron të marrë parasysh këshillat e ish-drejtorit të bibliotekës. Buda ia del të organizojë kartotekën dhe të hartojë një bibliografi dhe kur më pas gjendet në qilar Arkivi italian i Luogotencës, vihet baza e Arkivit të Shtetit. Regjimi po forcohej, kur Budës, që bën edhe lektorin e letërsisë për aktorët e Teatrit të sapongritur dhe shefin e Seksionit të Historisë në Institutin e Shkencave, i ngarkohet një detyrë e vështirë.

E kanë përzgjedhur të jetë pjesë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Vetë Buda ka rrëfyer se është befasuar kur e ka dëgjuar në radio se do të ishte pjesë e delegacionit të kryesuar nga Enver Hoxha dhe Hysni Kapo. Profesor Buda dhe Petraq Pepo studiojnë në ditët e fundit të korrikut dhe në dhjetëditëshin e parë të gushtit të 1946-ës literaturë e dokumente për çështjen shqiptare. Teksa qeveria greke kishte ngritur pretendime duke

e cilësuar Shqipërinë aleat të Boshtit fashist, delegacioni shqiptar duhej të hidhte poshtë me fakte dhe argumente Greqinë.

Mes drejtuesve komunistë, juristëve e diplomatëve, ai si drejtor i Bibliotekës Kombëtare rrëmoi e gjeti në fondet e saj gjithçka sa kishte, ndërsa Pepo shkoi në Korçë e mori nga biblioteka e qytetit gjithë dokumentet, letrat e memorandumet e Konferencës së Parisit 1919-1920. Në Paris delegacioni zyrtar shqiptar qëndronte në të njëjtin hotel dhe hanin të gjithë bashkë. Buda rezultoi ta ketë takuar atje për herë të parë Enver Hoxhën që e kishte dëgjuar gjatë luftës, por nuk kishte pasur rastin ta njihë. E përshkruante diktatorin atë kohë, si një njeri që duhej i hapur dhe bisedonte me ta në tryezë si një njeri i thjeshtë, sepse ende nuk kishte filluar kulti i individit.

Prof. Buda dhe Pepo morën pjesë në mjaft debate të hapura që organizoheshin jashtë Konferencës kundër pretendimeve greke. Pjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën e Paqes mundi ta rendisë vendin në krahun antifashist duke ruajtur kufijtë jugorë. Atje ia dolën ta ruanin Shqipërinë, po vendi po e hante elitën e vet.

Vetë jeta e profesor Budës, gjendet pranë një tehu të thike. Ai përgatitej për Konferencën e Paqes kur dy kunetërit e tij qenë arrestuar dhe ndodheshin në burg. Në letrën që ai i dërgon të shoqes, Vasilikës, para se të nisej për në Francë, i thotë se kishte qenë në burg dhe i kishte takuar vëllezërit e saj. I thotë se janë mirë, por se janë të trembur për ndonjë transferim në burgun e Burrelit. Ai e ndjente pra frikën dhe hijen e regjimit mbi kokë.

Teksa dhuna dhe represioni karakterizonin riformimin e marrëdhënieve shoqërore, studiuesi Pinari vëren se një operacion i tillë i madh nuk mund të kryhej vetëm nga organet represive,

por mbështetej në pranimin ose bashkëpunimin aktiv të atyre që përfitonin - ose që shpresonin të përfitonin - nga rendi i ri. Kontrolli tërësor i aktivitetit publik dhe privat krijoi tri lloj grupimesh në mesin e elitës. Ata që ju kundërvunë hapur e u dënuan ashpër ose u mënjanuan; ata që qëndruan në heshtje e të distancuar nga politika dhe zgjodhën jetën akademike dhe ata që u formuan dhe u vunë në shërbim të pushtetit duke qenë mjaft aktiv. Studimet theksojnë se shteti totalitar kishte marrëdhënie të dyfishtë me studiuesit; po aq sa mbaheshin nën kontroll dhe ju diktoheshin tematikat, po aq shiheshin me admirim nga pushteti si intelektualë me vlera dhe me autoritet të padiskutueshëm në publik.

Më 1948 Budës i arrestojnë të vëllanë, Stasin, sepse si trashëgimtar i farmacisë së babait nuk kishte shlyer tatimin e jashtëzakonshëm. Tatimi i vendosur ishte jashtë çdo logjike sepse nuk përputhej me të ardhurat e farmacisë. Buda mund të jetë thyer një çast atëherë, ndërsa më vonë ka rrëfyer se aty e kuptoi sa e fortë ishte dora e diktaturës së proletariatit. Pasi ishte dërguar që të punonte edhe në kënetën e Maliqit dhe autoriteti ishin bindur se nuk kishte mundësi të paguante, Stas Buda qe liruar pas një viti e gjysmë në burg.

Në kohën kur dënimet ndaj intelektualëve kundërshtarë ishin të ashpra, pati një grup prej tyre që kishin interes akademik dhe e shihnin krejt të pamundur të reagonin. Kjo i bëri ata të qëndronin neutralë dhe të ruanin përgjatë gjithë sistemit profilin e studiuesit të papërfshirë në politikë aktive. Edhe Prof. Buda bën pjesë në këtë profil. Si të tillë e vlerësojnë historianë me emër në vend që nxjerrin në pah aktivitetin akademik dhe qëndrimin politik thuajse neutral. Profesor Kristo Frashëri theksonte se Prof. Buda zgjodhi rrugën e mesme që ia diktoi nevoja që kishte vendi për punë kulturore dhe edukata rilindase që kishte marrë në familje. Qëndroi larg temave ideologjike dhe iu kushtua historisë së kaluar të largët që nga

Prof. Buda zgjodhi rrugën e mesme që ia diktoi nevoja që kishte vendi për punë kulturore dhe edukata rilindase që kishte marrë në familje. Qëndroi larg temave ideologjike dhe iu kushtua historisë së kaluar të largët

ilirët, tek Skënderbeu dhe tek Rilindja Kombëtare. Historiani Paskal Milo mendon se Prof. Buda i qëndroi larg angazhimit politik për shkak të formimit të tij perëndimor, bindjes se shkenca e historia ishin fushat e tij të veprimit dhe kënaqësia e jetës. Për Pëllumb Xhufin, Prof. Buda i shfrytëzoi marrëdhëniet e mira që kishte me regjimin për të ndikuar në promovimin e shkencave albanologjike duke filluar nga formimi brenda dhe jashtë vendit i specialistëve të latinishtes, greqishtes së vjetër dhe osmanishtes. Xhufi thekson se Instituti i Shkencave u bë një mburojë, ndoshta i vetmi vend ku mundën të punësoheshin a përfshiheshin në projekte shkencore bijtë e "klasave të përmbytura". Sot, bihet dakord se niveli i kërkimit shkencor në histori atë kohë u rrit, pavarësisht ideologjizimit që preku të gjitha shkencat si dhe historinë. Prof. Buda arriti të studionte tema të të gjitha periudhave historike me profesionalizëm.

Ishte shumë i apasionuar pas heroit kombëtar-Skënderbeu, duke arritur ta 'mbronte' atë nga urrejtja e regjimit për bejlerët. Ndërsa më 1952 në një konferencë të Institutit të Shkencave, Prof. Buda ia del të vendosë në sallën e madhe të Bibliotekës Kombëtare ku edhe mbahej takimi, një citat të Stalinit ku thuhet: "Asnjë shkencë nuk mund të zhvillohet e të përparojë pa luftë mendimesh dhe pa liri kritike". Parulla lexohet sot si një mesazh për studiuesit që të diskutonin lirshëm, por edhe për partiakët që të mos i 'kundërviheshin' Stalinit. Kontribut i madh i tij cilësohet maketi i historisë Shqipërisë, që u diskutua në shkurt të vitit 1952. Atëherë ai do të hidhte një nga parimet e rëndësishme metodike të shkrimit të historisë, duke këmbëngulur të krijoheshin skedarë sipas rendit kronologjik që përbënin skeletin e punës. Një vit më vonë gjejmë për të përgjime në Sigurimin e



**Burrit me ballë të gjerë, dikur
ju zbardhën flokët dhe iku.
E mbajnë mend si një njeri
që përpiqej të ndihmonte.
Ndërkohë, faktet tregojnë
për një burrë në pozicion
të dyzuar mes shkencës,
angazhimit politik dhe
problemeve familjare të
diktuar nga regjimi.**

Shtetit. Bashkëpunëtori "Dhëlpëria" raportonte për Budën më 24 dhjetor 1953 se "Bën përpjekje për të përvetësuar Marksizëm-Leninizmin, njuh mjaft Çështjet e Historisë, po ka konfuzion në kokë. Puna kryesore e Seksionit është Historia e Shqipërisë që po përgatitet. Nga sa kemi biseduar me Aleks Budën, monografitë e ndryshme nuk janë bërë në bazë të një modeli të përbashkët dhe as që janë biseduar përpara tezat e çdo monografie (siç bëhet fjala vjen në Bashkimin Sovjetik), po cilido ka vepruar sipas mendjes së tij". Ai është ndërkohë deputet i Kuvendit Popullor, në dy legjislatura, të viteve 1950-54 dhe 1954-58. Por nuk është i vetmi nga Instituti i Shkencave, duke qenë se pozicioni i deputetit dhe i vetë Kuvendit Popullor ishte i parëndësishëm për aq kohë sa zgjedhjet ishin formale dhe pushteti real ishte i papërfillshëm.

Ecejaket e tij të përditshme, endeshin nga rruga "Fortuzi" drejt Bibliotekës e Akademisë. Burrit me ballë të gjerë, dikur ju zbardhën flokët dhe iku. E mbajnë mend si një njeri që përpiqej të ndihmonte. Ndërkohë, faktet tregojnë për një burrë në pozicion të dyzuar mes shkencës, angazhimit politik dhe problemeve familjare të diktuar nga regjimi. Por sidoqoftë Prof. Buda arriti të përqendrohej gjithnjë e më tepër në çështjet e shkencës duke gjetur hapësirën e tij të lirisë së brendshme në atë kohë të vështirë. Pas arrestimit të kunetërve e vëllait, ai e ka ditur mirë cilat ishin pasojat nëse rebelohej. Ndonëse në heshtje, gjurmët e lëna tregojnë se nuk pajtohej me luftën e klasave, me mungesën e lirive, me persekutimet politike dhe me kufizimet drastike të kontakteve njerëzore, shkencore e kulturore me botën e jashtme.

Burri i ndrojtur që ndërtonte shkolla

“E shpëtoi heshtja. E dinte se nuk mund të fliste kundër shtetit. Qëndronte në hije gjithë kohën, rrinte në skaje, jo në qendër”.

Vlorë, mbrëmja e vitit të ri, 1926. Mësuesi shkodran që ka zënë një shtëpi të thjeshtë në qytetin buzë detit, ka marrë penën e ka vënë para një letër. Një shkrim i pjerrët, i rregullt, i harkuar, por i qartë, i kërkon revistës “Diturija” numrin e muajit janar. “Me vjetin e ri të më njehni edhe mue si pajtimtar i së përkohshmes ‘Diturija’... Po ju dërgoi edhe disa mendime të zgjedhura shkrimtarësh të huej. Disave u kam vu para origjinalin e përkthimin sidomos të mendimeve në gjuhën frëngjishte e italishte”. Kolë Kamsi është në këtë kohë 40 vjeç, drejton një shkollë në “Ujë të Ftohtë” dhe ka mundur tashmë të ngrrejë disa shkolla nëpër Shqipërinë e varfër të fillimeve të 1900-ës.

Ai vinte nga një prej familjeve më të mëdha shqiptare, historia e së cilës nis në shekullin e 12-të, e vijon deri në ditët tona. Rreth 16 pergamena që ruhen ende sot, flasin për këtë udhëtim nga një

shekull në tjetrin të familjes Kamsi. Të parët e tyre, kishin qenë sundimtarë në një prej qendrave më të zhvilluara të mesjetës, qytezës së Drishtit pranë Shkodrës. Nga pinjollët më në zë të tyre, ishte edhe Kolë Kamsi- folklorist, mësues, pedagog i gjuhës shqipe, hartues tekstesh shkollore, përkthyes, prozator, fabulist, publicist e redaktor, studiues në zë i gjuhës shqipe e traditave.

Jetëshkrimi i tij të çon në qytete e shkolla të ndryshme të Shqipërisë, herë si mësues e herë si drejtor gjimnazesh, madje edhe themelues i tyre; e gjejmë si drejtues kursesh për mësuesit e paktë të vendit në atë fillimshekulli, por e gjejmë edhe studiues në Institutin e Studimeve Shqiptare.

Ajo çfarë ka lënë pas, është një thesar, ndonëse emri i tij nuk njihet së gjeri. Profilët e shkruara prej tij për figurat më të mëdha historike a letrare të vendit, përkthimet a botimet, dëshmojnë për dije e maturi,



[Faint, illegible text overlaid on the man's face]

INVIATO DA ROMA TELEGRAMMI
IL GIORNO 21 OTTOBRE 1905

21.10.1905

R. D'Agostini

[Faint, illegible text in the bottom right corner]

duke e dhënë po aq dritë vetes sa edhe atyre që studioi Kolë Kamsi. Historia e tij, megjithatë, nis e mbyllet në Shkodër, ku pat lindur si bir i një tregtari e mësuesi më 23 shtator 1886. Pasi kreu mësimet e para u diplomua në San Demetrio Corone (Itali). Më 1907, në moshën 21-vjeçare, Kamsi kthehet në Shqipëri dhe emërohet mësues i gjuhës shqipe në qarkun e Vlorës. E gjen arsimin në gjendje të vështirë, me një numër të madh analfabetësh. Trishtimit i të riut që vjen nga një shkollim jashtë, nuk e mund. Ai ndërmer

në Vlorë një kurs afatshkurtër pedagogjik, që u jepte mësuesve metodat didaktike për mësimdhënien.

Vitet kalonin por shkolla shqipe e arsimit ishin ende në hapat e parë e të pakonsoliduar, ndaj Kamsi nisi të plotësonte mangësi të tjera, ku mundej e si mundej. Hartoi tekstet bazë për shkollën fillore, si abetarja "Jeta e re"(1915) me 72 faqe, tekstin "Mësime përmbi natyrën" (1917), 60 faqe dhe antologjinë me vjersha për shkollën fillore "Lulet e mendimit" (1919)



Kartolina dërguar revistës "Diturija"

Studim i Kolë Kamsit

“Miq të e kujtojnë atë si një njeri që punonte në heshtje, rregullisht dhe palodhje. Ata e kujtojnë atë si njeriun që i dedikoi jetën e tij arsimit pa pritur që të nderohet”

nismën për hapjen e 44 shkollave elementare për t'i mësuar shqip fëmijëve në Vlorë dhe Gjirokastrë. 7 vite më pas, kur më 1916 emërohet drejtor i shkollës së parë fillore për djem, kupton që pos nxënësve, nivel të ulët përgatitjeje kishin edhe vetë mësuesit. Duke e ditur se ata përçonin dijet e veta të pakta, në shkollat ku jepnin mësim, Kamsi me Jani Mingën çelin

52 faqe. Mësuesi i fëmijëve i kish kaluar tashmë të 30-at, ndiqte jetën intelektuale të qytetit dhe ishte anëtar i klubit "Labëria". Si pjesë e elitës së qytetit ai lidhet edhe me teatrin e arrin të vërë në skenë dramën "Vdekja e Pirros" e Mihal Gramenos, një luftëtar i lirisë e nacionalist. Për 13 vite në Vlorë ai hapi disa shkolla dhe më 1920, kur mbaroi Lufta e

Parë Botërore që e pat kthyer Shkodrën në shesh lufte, u kthye në qytetin e lindjes.

E emëruan mësues në shkollën françeskane në Shkodër për dy vite, ndërsa Kongresi Arsimor i mbajtur në Tiranë e zgjodhi një nga 12 anëtarët e komisionit që do përgatisnin reformën arsimore, programet dhe tekstet shkollore dhe do merrnin vendimet për ecurinë e sistemit arsimor në Shqipëri.

Më 1922, kur me kërkesë të Luigj Gurakuqit hapet një shkollë e mesme në Shkodër, Kamsin e çojnë të japë aty gjuhë dhe letërsi. Tri vite më vonë, emërohet drejtor dhe pedagog i kursit pedagogjik që Ministria çeli në qarkun e Korçës për përgatitjen e mësuesve, që do të jepnin mësim në shkollat e këtij qarku. Vetëm një vit më pas, ai ishte drejtor në Institutin Tregtar në Vlorë dhe është koha kur ai shkruan letrën. Jeta e tij vijon të jetë e vrullshme. Edhe në vitet në vijim, si ato më parë, e gjejmë herë drejtor e herë mësues në shkolla të ndryshme. Gjatë pushtimit është drejtor në Institutin "Nana e Skënderbeut", më pas në Komisionin Teknik të hartimit të teksteve dhe më 1940 punon pranë Institutit të Studimeve Shqiptare.

E çojnë sërish në Shkodër dhe e kthejnë sërish në Tiranë si studiues në gjuhësi e arte. Komunizmi ishte imponuar dhe po krijonte njeriun e ri, kur më 1948, Kamsi punon në Institutin e Studimeve në Tiranë, si folklorist. Ethet e arrestimeve e internimeve ndiheshin kudo.

Kol Kamsi i mbijetoi persekutimit dhe përndjekjes duke qenë se u fokusua tërësisht në punën e tij akademike dhe arsimore. Brenda "lirisë së ndrydhur" që instaloi regjimi, shumë intelektualë ia dolën të vijonin të shkruanin a studionin në fushën e letërsisë, historisë, folkloristikës. Megjithë natyrën e tërhequr e gojën e mbyllur, mësuesi që pothuaj ngriti po aq shkolla sa një qeveri, nuk i shpëtoi dot gjithsesi procedurave hetimore. Studimi

i Eriketa Pandelejmonit dhe Enxhi Bekës, mbi të cilin bazohet ky artikull, e vërteton hetimin e tij. Nga një procesverbal i vitit 1950 nga organet lokale në Shkodër, mësohet se pse ai u mor në pyetje. Shqetësimet e regjimit kishin karakter biografik. Donin të dinin, nëse Kolë Kamsi, kishte marrë pjesë në Luftën nacionalçlirimtare. Arsimtari mohoi, e me gjasë i trembur, shtoi se nuk kishte kryer as shërbimin ushtarak. Në pyetjen e rradhës, i kërkohet të tregojë se në cilën organizatë ka bërë pjesë para çlirimit. Mësuesi mohon i habitur e thekson se nuk ka qenë kurrë pjesë e asnjë organizate. "Si arsimtar kam qenë antar i Partisë Fashiste dhe Bashkimit Profesional në organizatën e Frontit Demokratik në Kryqin e Kuq në Lidhjen Kulturorë".

Kamsi nuk arrestohet, as nuk përndiqet, ai nuk dënohet asnjëherë me apo pa gjyq. Duket se figura e tij, tashmë në të 60-at i bind se nuk ka gjë për të fshehur, as fuqi për të rrëzuar regjimin. Ndryshe prej shumë intelektualëve, që pësuan internimin, ai mundi të jetojë me familjen. E shoqja Gjyzepe Kamsi ishte shtëpiake, i biri Paolin Kamsi ishte mësues në Rrëshen, djali tjetër Karlo Kamsi ushtronte profesionin e kursistit në Tiranë. Ndërsa e bija, Terezina ishte nxënëse në Shkodër. Pas shqyrtimit me kujdes në lupën e kontrollit të sistemit për të gjithë familjen e tij, në vlerësimin final të procesverbalit, Kamsi etiketohet si njeri i sinqertë.

Në këtë kohë, vitet 1950- 1955, e kanë rikthyer në Shkodër si profesor të gjuhës dhe letërsisë në gjimnazin "29 Nëntori" dhe njëherësh profesor në shkollën pedagogjike "Shejnaze Juka". Pasi rivlerësojnë figurën e tij, më 1955 e zgjedhin "Kandidat të Shkencave" ndërsa më 2 shtator 1957 kur themelohet Instituti i Artit Pedagogjik 2-vjeçar në Shkodër, Kamsin e emërojnë pedagog të folklorit dhe gjuhës shqipe në Fakultetin e Gjuhës dhe Historisë. Aty punoi deri më 25 shkurt 1960, kur u nda nga jeta në moshën 74-vjeçare, pas 53 vitesh ndihmë në vendosjen e themeleve të arsimit shqiptar.

Kishte bërë ndërkohë dhjetra studime, deri edhe hartimin e Fjalorit arbërisht-shqip që ia kishte ngarkuar Instituti i Gjuhësisë dhe Historisë në Tiranë. E ndjente se gjendja e tij shëndetësore po përkeqësohej, ndaj punonte ditë e natë. Një ditë para se të mbyllte sytë përgjithmonë, më 24 shkurt të vitit 1960 tekta i dorëzonte i shtrirë në shtrat veprën e tij, “Fjalorit arbërisht-shqip”, prof. Mahir Domit, i thotë ngadalë: “Po vdes i qetë. Zotimin e marrë para Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë e mbajta”. Me studimet e veta ai provonte se “Katundet shqiptare të Kalabrijes së Veriut e të Basilikatës e ruejten ma tepër karakterin e tyre etnik”, duke theksuar se gjuha shqipe nuk flitej vetëm brenda shtëpisë, por dhe jashtë.

Prej 1907-ës Kolë Kamsi kishte punuar pa rështur mbi fonetikën, morfologjinë dhe veçanërisht për leksikun e arbërishtes (shqipe e vjetër e folur prej arbëreshëve, shqiptarëve që ikën në mesjetë dhe u vendosën në Itali pas pushtimit osman). Ai fjalor është cilësuar kryevepra e tij. Me rreth 8000 fjalë dhe fraza të nxjerra drejtpërdrejt nga veprat e shkrimtarëve arbëreshë nga Lekë Matranga e deri te autorët e 1960-ës, ai u botua vetëm pas 40 vjetësh. Ndonëse i përfunduar, fjalorin që Kamsi e pat dorëzuar brenda afateve të caktuara duke i kushtuar deri edhe orët e fundit të jetës, do ta linin të “flinte” për dyzet vite me radhë në Tiranë.

Qe i biri i mësuesit që e gjeti në dorëshkrim në një magazinë të Institutit të Gjuhësisë me ndihmën e Bahri Becit, që drejtonte atëkohë këtë institucion. Fjalori u botua në vitin 2000, pas një redaktimi nga profesor Ferdinand Leka.

Studimet albanologjike të Kamsit përfshinin katër aspekte, gjuhësinë, letërsinë, folkloristikën dhe historinë. “Manuali Praktik i Gjuhës Shqipe” shkruar italisht-shqip për strukturën gramatikore pati tri botime në Zarë të Dalmacisë më 1930, dhe në Shkodër më 1940 e 1941. Kontribut i padiskutueshëm janë dhe monografitë “Jeta dhe Vepra e Frang Bardhit” dhe

“Disa vërejtje gjuhësore mbi Pashko Babin”, të dy klerikë të mesjetës që kanë lënë dëshmi të shumta për arbrit, shqiptarët e kohës.

Pos poezive për fëmijë që shkroi, a tregimeve edukative, ai pati përkthyer edhe Andersenin, Lasingun, Vëllezërit Grim, Hygoïn, Bokaçon, Tolstoin. Në lëmin historik ai shkroi “Udhëtim i Skënderbeut në Romë”, “Dita 28 Nëntori”, “Kryengritja e Malësisë së Madhe”, apo “Një letër Abdyl Frashërit e Françesko Krispit”. Me rastin e 25 vjetorit të pavarësisë, më 1937, kishte botuar “Dokumenta të Agimit të Lirisë”, ku përfshiheshin promemorie, protesta, peticione, memorandume të kolonive shqiptare në Egjipt, Rumanë e Turqi si dhe artikuj të dërguar nga shoqëritë e klubet shqiptare që vepronin në emigrim, si edhe shkresat që u ishin dërguar Fuqive të Mëdha për njohjen e Shqipërisë. Kamsi kishte



Kamsi në të djathtë, me një mik të afërm

**Tri vite para se të shuhej,
mësuesi Kolë Kamsi u
dekorua me “Urdhërin e
Flamurit”**

botuar studime edhe për figura të njohura si Pashko Vasa, Filip Shiroka, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Fan Noli, Marko Boçari a Justin Rrota. Një vëmendje të veçantë u kushtoi shqiptarëve të diasporës, si Milo Duçit, i njohur ndryshe si Sulo Malësori, për të cilin Kolë Kamsi shkruan: “Ka qenë një puntuer i palodhur që me pendë ka ndezë e mbajtë gjallë në kolonin e shqiptarëve të Misirit(Egjipt), flakën e atdhedashurisë e i ka sjellë shërbime të mëdha çështjes shqiptare e gjuhës shqipe”.

Publicistika e tij gjendej brenda e jashtë vendit, nga “Albania” e Londrës më 1907, tek “Kalendari Kombiar” në Sofje më 1912, a te “Përparimi” në Shkodër më 1915. Shkrimet e tij zinin vend në “Corriere della Puglie” në një numër të posaçëm për Shqipërinë më 1917. Tekstet shkollorë që hartoi u përdorën nga nxënësit për tridhjetë vjet (1915-1945) dhe u hoqën më 1945 kur po instalohesh diktatura komuniste. Tri vite para se të shuhej ai u dekorua me “Urdhërin e Flamurit”, ndërsa pas rrëzimit të diktaturës iu dha titulli “Mësues i Popullit”.

Më 25 shkurt 1960, personaliteti i shquar Kolë Kamsi ndahet nga jeta. U përçoll për në banesën e fundit me një ceremoni të madhe organizuar nga intelektualë të fushave të ndryshme të vendit, përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Akademia e Shkencave Tiranë, intelektualë nga Instituti pedagogjik, dhe gjimnazi i shtetit, që bashkë me nxënësit shkollash dhe studentë, shoqëruan kortezhin e përmoshëm me kurora në duar nën tingujt e bandës së qytetit përgjatë bulevardit. Shkrimtari i njohur Petro Marko, ka shkruar për mësuesin e tij se ishte “i heshtur, por punëtor i madh. Ai bënte gjuhësi, gramatikë, lexim dhe hartim. E them me plot gojë se na mësoi shqipen mirë: gramatikën, poetët tanë,

historinë e shkrimit të shqipes dhe kulturës tonë”. Miqtë e kujtonin si një njeri që punonte në heshtje, me rregull e pa u lodhur. Kujtonin edhe se Kolë Kamsi i qe kushtuar krejtësisht e me gjithë shpirt arsimit pa pritur shpërblime, pa kërkuar lavdërime e çmime.

“Babai qëndronte në hije gjithë kohën. Edhe kur shkrepeshin fotografi, në aktivitetet që merrte pjesë, rrinte në skaje, jo në qendër. Në shtëpi ishte i qetë, i heshtur dhe nuk fliste shumë”. Karlo Kamsi e ka humbur të atin pothuaj 50 vite më parë. Pesë dekada më pas rrëmon në kujtesë për t’iu përgjigjur pyetjeve mbi të. Rreket të sfidojë edhe moshën e tij, duke sjellë ndërmend fëmijërinë e largët dhe fragmentet e kujtimeve me figurën atërore të vagullt.

“E nisi punën si mësues më 1907, por ende sot, kushdo që më takon më pyet për të. E çmonin, sepse ishte i thjeshtë, edhe pse thjeshtësia të lë në hije”. E kujton atin në shtëpi si një njeri që fliste pak, edhe pse kishte punuar me Eqrem Çabejn a Aleksandër Xhuvanin. E pyes nëse ai pat frikë nga regjimi, persekutimi, kur shumë figura si atë, i arrestuan dhe i lanë burgjeve. I biri mohon. “Nuk mendoj se kishte frikë. Im atë ishte i pastër, edhe pse dajën tim, kunatin e babait e patën dënuar. Babain e shpëtoi heshtja. E dinim gjithsesi se kundër shtetit nuk mund të flisnim. Ai punonte e nuk fliste, ndaj shteti u detyrua të mos ia mohojë meritat. Punoi deri ditët e fundit të jetës. U sëmur në punë në Tiranë. Erdhi në Shkodër dhe zuri krevatin një muaj. Dhe pastaj u nda nga jeta”, thotë djali i tij Karl Kamsi. La pas edhe dy fëmijë të tjerë, Paolinin që sot nuk jeton më e Terezinën që është gjallë.

Kujtimi i emrit të tij është ende i fortë në Shkodër. Rrugica e shtëpisë së familjes Kamsi, është prapë rrugica e librave.

Dinjitet mes autoritarëve

la kishte dalë të ruante sa mundej shokët, dinjitetin e jetën e tij dhe familjes, ndonëse njolla s’iu hoq ndonjëherë e as vëzhgimi. Ia kishte dalë të jetonte lirinë e kontrolluar pa i hequr për këtë, lirinë e askujt.

Petra Qafoku ishte 28 vjeç më 1944 kur vinte në Shqipëri nga “La Sapienza” në Romë me një diplomë inxhinieri miniere. I kishte nisur studimet në Bukuresht dhe i kishte kryer në Itali ndërsa lufta kishte filluar e mbaruar. Kthehej me dëshirën e madhe të bashkëkohësve të vet për të ndërtuar vendin e rrënuar. I vogël kishte mbetur jetim, e ndonëse vinte nga një familje tregtare nuk kish trashëguar prona a pasuri. Të afërmit e kishin ndihmuar të shkollohej prej rezultateve të mira në gjimnaz ndaj kthimi dhe vendosja në qytetin e lindjes në Berat, kur Roma në Italinë e pasluftës mund t’i ofronte një jetë krejt tjetër, nuk mund të ishte tjetër pos një dashurie për vendlindjen. Vendimi i tij i përgjigjet klimës shpirtërore të shumë intelektualëve shqiptarë që e kishin mjaft për zemër fatin e Shqipërisë.

E bën edhe më idealist këtë udhëtim, fakti që jetesa në vendin fqinj e kishte vënë në kontakt me

literaturën që përshkruante tragjeditë e persekutimit në Bashkimin Sovjetik. Ndërsa modeli sovjetik po mbërrinte në Shqipëri, ndonëse interpretohej me ideale të mëdha, një i ri me formim intelektual mund ta ketë marrë me mend, se një ditë pas ideve të mëdha, do të shfaqej fytyra tjetër e asaj ideologjie. Dhe nuk vonoi, sepse në fundin e 1944-ës kishin nisur tashmë gjyqet ushtarake. Antropologu Albert Nikolla mbi studimin e të cilit bazohet ky artikull e cilëson një gjest heroik ardhjen e tij në Shqipëri teksa vë në dukje se Qafoku u vu menjëherë në dispozicion të punojë pranë Qeverisë Provizore të sapoformuar.

Pas çlirimit të vendit inxhinieri punon në institucione që merreshin me ndërtimet dhe çështjet ekonomike. Nisur nga nevoja e madhe e regjimit për të ardhura në valutë dhe ekzistenca e pak ndërmarreve që prodhonin për eksport, Qafoku dërgohet në Minierën e Selenicës në fund të vitit 1945 për ta ngritur atë në kushte prodhimi, pasi


10 vjet prives liris

10 vjet prives liris, me konfirmimin e pasurise, me krahjen e drejtes sektorien per pesë vjetore/

... luten te mos falni per gjuetia qe marr lju drejtesha juve...
... dokumenti Nr. 351 dt. 25.9.1948 te gjykates se liris...
... Me vendimin Nr. 328 dt. 10.12.1948 te gjykates se liris...

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALE SHQIPTARE
GJYKATA E LIRISE, 1978, Krijuesit e Regjistrit dhe me lishojat nje lishore
Regjistri i Gjendjes Gjyqesore (me Shkator 1947) dhe e detyro
... Me vendimin Nr. 351 dt. 25.9.1948 te gjykates se liris...

Tirane, me 3.7.1979



ishite në gjendje të shkatërruar nga lufta. Por situata në vend dhe nevoja për profesionistë bëjnë që ai të përfshihet në disa aktivitete profesionale ku kërkohej ekspertiza e tij, jo vetëm në Selenicë, por edhe në Kuçovë. Ishte koha kur punëtorët bënë punë krahu, me kazma e lopata duke qenë se mungonin makineritë e nevojshme çfarë e vështirësonte akoma më shumë arritjen e synimeve.

Ndonëse puna dhe njohuritë që bartte qenë të domosdoshme, regjimi i ri e shihte me "kujdes" të madh inxhinierin. Si i shkolluar jashtë, ai konsiderohej "njeri i vjetër" dhe i painedoktrinuar me idetë komuniste që përvijonin fytyrën e regjimit të ri të fituesve të luftës. Në kantierin e Kuçovës, me gjithë përkushtimin e jashtëzakonshëm profesional, gjatë punës has vështirësi të mëdha nga elementë të Sigurimit të Shtetit që e ndiqnin.

Një ditë nëntori të 1946-ës, në Tiranë nga altoparlantët e kinemasë "Nasional" jehonte bujshëm gjyqi kundër inxhinierëve sabotatorë të Kënetës së Maliqit, që nuk e kishin tharë atë në kohë. Në këtë atmosferë, ndonëse kishte punuar me përkushtim, tri vite pas kthimit, kur ishte 31 vjeç Petraq Qafoku, inxhinier miniere, arrestohet në Tiranë më 18 shtator të vitit 1947.

Akuza ndaj tij është e rëndë për kohën. Ai kishte parë kolegët të dënoshin me vdekje për të njëjtën akuzë një vit më parë. Si te ata edhe të Qafoku shfaqet e frikshme fantazma e sabotimit, si moskryerje me vetëdije dhe me qëllim e një pune të marrë përsipër. Dokumentet e kohës, të vëna në dispozicion nga Autoriteti për Informim mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, nxjerrin në pah një koordinim, sot të paimagjinueshëm, të dashakeqësisë, injorancës e intrigës së hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve.

Procesverballi i mbajtur gjatë gjyqit nxjerr akuzat e sabotazhit, bashkëpunimit me elementë kundërshtarë dhe e zbatimit të porosive të tyre kundër vendit.

"Prokurorija ushtarake e këtushme, me komunikatën e saja, Nr. 242, i ka sjellë kësaj gjykate proces verbalin e mbajtur nga ana e Seksjonit të Sigurimit të Shtetit Tiranë, kundra të pandehurit Petraq Qafoku, i reshtuar dhe i akuzuar si dhe i pajisur me një edukatë fashiste gjat okupacionit është treguar Anëtar Aktiv i Partisë Fashiste. Në lidhje me Ing. Taraskinon, Zyberin e të tjerë ka rënë në lidhje me ta dhe në çdo mënyrë është përpjekur të sabotojë punën ekonomike si mbas direktivave të organizatës së agjento- sabotatorëve". I qëndron si hije, koha e studimeve në Itali, sepse akuzohet se kur ishte në Romë përvetësoi kulturën fashiste dhe e propagandoi atë. Për hetuesit ai "ka patur lidhje me elementa reaksionar të arratisur politik jashtë shtetit, n'Itali i kanë dhënë letra dhe lidhje për elementa reaksionar të vendit t'onë". Duke qenë se njihej me inxhinierin italian Taraskoni dhe me Prof. Zyber Stanislav, akuzohet se është nxitur prej tyre dhe ka sjellë pengesa dhe çrregullime në punimet e kantierit të Kuçovës. Bisedat rastësore që mund të kishte bërë në ato tri vite të jetës në atdhe, shihen si plane të organizuara kundër pushtetit, ndaj hetuesit thonë se "ka bërë mbledhje me karakter politik me elementa të ndryshëm kundërshtar që punojnë në këtë minjerë dhe ka sabotuar në prodhimin e kantjerit të Selenicës."

Ata shtojnë se Qafoku nuk i ka premisat morale për të dhënë një kontribut me vlerë ideologjike në ndërtimin e socializmit, çka vetë inxhinieri e pohon me një sinqeritet të rrezikshëm. Për një mendje të kthjellët e normale, modulet e lëndëve të studiuara në universitet nuk nënkuptojnë automatikisht se ai ishte agjent i fashizmit, por për një hetues komunist ky është një fakt që përbën pistën kryesore e hetimit. Këmbëngulja për të nxjerrë në pah mungesën e moralit komunist tek inxh. Qafoku e detyrojnë këtë të fundit të nënqeshë. Tashmë Petraq Qafoku e ka kuptuar se dënimi është i pashmangshëm ndaj përdor një ironi therëse, duke e çarmatosur atë që ka përballë. Ndaj kur e pyesin se cila ka qenë detyra e tij si shqiptar, të qëndronte e të luftonte fashizmin që

okupoi atdheun apo të rikthehej në Romë në vatrën e fashizmit siç qe kthyer, inxhinieri përgjigjet si një fëmijë i zënë në faj se “detyra ime ishte të qëndronja në Shqipëri si shokët dhe të mirra pjesë në Lëvizjen N . Ç . L , por unë veprova në të kundërtën, u ktheva në universitetin e Romës Fashiste; qëndrimi im në këtë rast ishte i keq dhe jo i mirë”.


Dialogët mes të pandehurit dhe hetuesit nxjerrin në pah jo vetëm dramën e të akuzuarit por edhe anën groteske të regjimit. Për studiuesin e inxhinierit, pranimi i disa të vërtetave bëjnë që ai të dënohet por të mos shkojë drejt dënimit me vdekje. Megjithatë, dhuna ndaj Qafokut nje skaje të tmerrshme. I mbajtur për një vit në hetuesi për ta nënshtruar që të bënte deponime të rreme kundër kolegëve, ku i kërkohej t'i paraqiste miqtë si agjentë të shërbimeve të huaja, ai dëshmon dinjitet dhe qëndresë. Për 24 ditë me radhë lihet pa ushqim dhe vetëm me një sasi të vogël ditore uji. E megjithatë nuk përkulet. Refuzon të japë dëshmi të rreme, refuzon të firmosë çdo dokument kundër kolegëve. Dhuna mbi të është e pashmangshme. Ndonëse i domosdoshëm për regjimin si profesionist, ai duhej të kuptonte se nuk ishte i lirë. Dhe ai e kish kuptuar tashmë, ndonëse kishte zgjedhur qoftë edhe të vdiste, por pa u bërë levë që të dënoheshin të tjerë. Rrëfime nga familjarë e të afërm të inxh. Qafokut kanë dëshmuar se gjatë hetuesisë është kërcënuar disa herë me vdekje.

Por, asgjë nuk e thyen sa të pohojë gjëra të paqena. Mes presionit, torturave, kërcënimeve, mungesës së ushqimit e ujit, ai i mohon të gjitha. Nuk pranon të ketë qenë pjesë e atij që njihet si grupi armik i Kuçovës, mohon se ka marrë udhëzime apo se ka bërë mbledhje me karakter politik kundra Pushtetit Popullor. Refuzon që ka sabotuar punën (prodhimet) në kantierin e Selenicës. “Kam punuar sa kam mundur për të mirën e pushtetit popullor, deri në ditën e arrestimit tim më 18 shtator 1947”, thotë ai pas një viti hetuesie.



Petraq Qafoku me bashkëshorten / Arkiva familjare

Petraq Qafoku, ashtu si anëtarët e tjerë të panumërt të klasave të edukimit, fillon të hasë vështirësi të mëdha nga Sigurimi i Shtetit



Letër dërguar Enver Hoxhës (1978)

Vendimi i gjykatës(1979), pafajësia e Qafokut



Qafoku gjatë të '60ve / Arkiva e Familjes

“Njeri me autoritet të lartë, përballë njerëzve autoritarë”, kujton një prej tyre, duke vënë në dukje autoritetin që i jepte dinjiteti jo pushteti

Dënohet me 10 vite burg megjithëse i mohoi të gjitha e megjithëse kundër tij nuk kishte fakte. Pasi i komunikohet vendimi, regjimi kupton se ka nevojë për njohuritë e tij teknike. Ndaj organizohet një seancë tjetër gjyqësore në dhjetor të vitit 1948, ku i dënua shpallet i pafajshëm. Ka pak të dhëna për periudhën mes dy vendimeve dhe se çfarë ndryshoi realisht në kaq pak kohë, apo se si vetë ai e përjetoi ndarjen me thikë të dy vendimeve, por pasi e lënë të lirë, e vënë në punë.

E megjithatë, presioni nuk ka mbaruar. Mbahet vazhdimisht nën mbikëqyrje gjatë punës nëpër kantieri dhe qëndrimi i kuadrove partiakë ndaj tij është mosbesues. Ai e ndjen dhe e di se dënimi i tij, edhe pse ishte shpallur i pafajshëm, ishte një “njollë biografike” e pashlyeshme. Ofendohet para kolektivit edhe kur nuk është më në burg. Kishte kryer studimet si inxhinier, por i jepet medalja “Punëtor i dalluar” kur shteti i kohës kishte edhe medaljen “Inxhinier i dalluar”. Ai po trajtohej si punëtor kantieri dhe jo si inxhinier. Pavarësisht asaj që ndjente miqtë që e kanë njohur në të gjallë, kujtojnë se ishte i jashtëzakonshëm. “Njeri me autoritet të lartë, përballë njerëzve autoritarë”, kujton një prej tyre, duke vënë në dukje autoritetin që i jepte dinjiteti jo pushteti. Kalvari i vuajtjeve të tij mjerisht kishte ndjekur edhe familjen, bashkëshorten dhe dy djemtë. Ata ishin gjatë gjithë kohës së regjimit komunist të vrojtuar nga Sigurimi i Shtetit. Jeta e tij endet mes një lirie që e dinte se ishte e kontrolluar.

Kur kishin kaluar 30 vite, e ishte viti 1978, e i biri i inxhinierit, Luka, përgatiste dosjen për punësim, zbulon se i ati rezultonte akoma në regjistrat e gjykatës si person i dënuar. Pafajësia e tij nuk i është regjistruar dhe i biri mund të mbetej pa punë. I gjetur para kësaj situatë sa absurde, 62-vjeçari Petraq Qafoku vendos t’i drejtohet me një letër vetë diktatorit Envert Hoxha. Intelektuali detyrohet të ulë sërish kokën. Ai e di se diktatori (shkaktari) ishte i vetmi që mund t’i jepte zgjidhje kalvarit të pafund.

“Shoku Enver. Ju lutem të më falni për guximin që marr t’ju drejtohem Juve personalisht, por e bëj këtë sepse problemi që shtroj ka rëndësi shumë të madhe për punën e jetën time. Im bir kërkoi një dokument për gjendjen time gjyqësore, duke ditur se kam marrë pafajësinë për një dënim të dhënë... Ju lëshua një dokument që vërtetonte se unë figuroja akoma në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore të Gjykatës së Lartë si i dënuar... U shtyva t’ju shkruaj këtë letër sepse unë dhe fëmijët e mi do të mbanim për gjithë jetën pa të drejtë njollën e tradhëtarit”. Letra, në ato pak radhë që ka, shpreh gjithë dramën e tij. Nuk mori kurrë përgjigje prej Hoxhës, por një vit më vonë, më

3 korrik 1979 dëshmisë së mëparshme të penaltetit i shtohet edhe një rresht: “Me vendimin Nr. 328, dt. 10/12. 1948 të Gjykatës së Lartë ka marrë pafajësinë.

Sot, kur ai nuk është më, dy djemtë kanë ndjekur rrugën e tij, njëri në Akademinë e Shkencave në Tiranë dhe tjetri si pjesë “Agjencisë Federale të SHBA-së për Studimin e Tokave”. Petraq Qafoku u kishte dhënë shembull jetën e tij. Ia kishte dalë të ruante sa mundej shokët, dinjitetin e jetën e tij dhe familjes, ndonëse njolla s’iu hoq ndonjëherë e as vëzhgimi. Ai ia kishte dalë të jetonte lirinë e kontrolluar pa i hequr për këtë, lirinë e askujt.

Të mbijetosh, nga iluminizmi te marksizmi

Historiani që ruante frymën e shkollës së Parisit duhej ta shkruante historinë sipas shkollës marksiste të mendimit historik, me të cilën nuk ishte familjar.

“**I**shenjtë qëllimi, më i shenjtë, kur shpëton njeriu popullin nga feudalët, kur s’e lë bujkun të jetë rob dhe, në fund, kur shpëton shtetin”. Petraq Pepo është liceist kur përmes një reportazhi, përshkruan udhëtimin e tij me nxënës të tjerë nga Korça në Tiranë për të rrëzuar mbretin Zog. Duke lënë të kuptohej se ishte ideali që i kishte bërë të linin mësimin dhe të rrëmbenin armët, korçari i lindur më 1903 në rugicën e kalldrëmtë pranë shtëpisë së patriotit Themistokli Gërmenji, premtori të jetë i guximshëm kundër tiranive. Atëkohë, ai drejtonte revistën letrare “Shpresa”, ku botonte përkthime nga iluministët francezë Russaux e Voltaire a të shkrimtarëve si Moliere.

I madhi prej tetë fëmijëve të familjes Pepo, në moshën 14 vjeçare, ishte një nga 36 nxënësit e parë që u regjistruan në Liceun Francez dhe ndër 9 të parët që u diplomuan aty më 1925.

Megjithëse kishte mbështetur Lëvizjen e Qershorit dhe Fan Nolin që rrëzoi mbretin Zog, mbreti e kishte rimarrë pushtetin kur Pepos iu miratua nga qeveria kërkesa për mbështetje financiare për studime të larta jashtë vendit. Ai shkon në Ecolé Normale Superieure në Paris dhe katër vite më vonë diplomohet për Licences-Lettres (Histoire et geographie). Më 1928, studenti shqiptar i kishte rënë në sy ballkanologut Mario Roques. Kërkimet personale të të birit, Leonidha Pepo, tregojnë se ai u bë lektor për gjuhën shqipe, historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë në Universitetin e Lyonit.

Pas kthimit në atdhe jep lëndët e historisë, gjeografisë dhe greqishtes së vjetër në Liceun e Korçës. Mandej, për vitet 1930 ka pak të dhëna punën e tij. Kërkimet në Arkivin Qendror të Shtetit, tregojnë se profesori ambicioz ka marrë disa herë leje nga Ministria e Arsimit për të shkuar në Austri, Francë dhe Itali për konferenca a kërkime shkencore.



I dashu Loh Noy

*Historia sille og lumbodde q' liften
to unen, q' udrit te skussan syks
pa up' lifte te uple errevren, pa te
kito lumbodde dulet dylle, kito dylle
han me mundem mblita, pa dle
ta puru pa redter dyke mblidhan
din a dulan ni pa luhel a ndryg
kistlu dulet mblidhan dle ten
han gjuuar skumentat
ye lumbodde te mni
vijter ni tiro luhel
gith gytetes
din, ku
biri lumbodde*

233

*I dashu dhe i merruari Shoku
... 1977
... Institutit Histori-Ojshwa
... profesor dhe
... shprehur dhe te
... kan perqendruar
... shprehur qe
... shprehur qe
... shprehur qe
... shprehur qe*

*Dikung Pegg
ne pansion*



Special Ushtarak, vinte në rrezik çdo njeri që kishte pasur afërsi me të. Harresa a heshtja ishin vetëm dy prej sfidave me të cilat do të përballlej profesori në vitet pas Luftës së Dytë Botërore.

Megjithëkëtë, tiparet e guximit kundër tiranisë dalin në pah edhe gjatë pushtimit. Pas demonstratave që bënë studentët e Liceut të Korçës në nëntor 1939, ai transferohet në Shkollën Normale të Elbasanit. Zyrtarët

Ai është një personazh interesant sepse kurrë nuk shfaq entuziazëm ose armiqësi ndaj regjimit. U mundua të përshtatet, por ndonjëherë natyra e tij rebele nuk e lejoji atë të veprojë ndryshe



Petraq Pepo / Arkiva e familjes

Athina, Parisi, Vatikani qenë pjesë e projekteve të tija studimore, ndonëse sot nuk dihet nëse ai, mundi t'i realizojë. Në këtë kohë ai ka letërkëmbime me emrat më në zë të kulturës shqiptare nga Lef Nosi, te Ilo Mitkë Qafzezi e Mehdi Frashëri. Përgjigjet e letrave që ai i ka dërguar Nosit, nuk gjenden as në arkivat shtetërore, as në arkivin personal të familjes. Vetë Pepo, pas Luftës së Dytë Botërore, nuk ka folur kurrë mbi njohjen dhe bashkëpunimin e tij me të, madje as në biseda intime me familjen. Shpallja e Lef Nosit si "armik i popullit" dhe dënimi i tij me vdekje nga Gjyqi

fashistë e cilësonin antiitalian e "nxitës për rebelimin e studentëve, të cilëve u ka folur me ekzaltim për Francën". 36-vjeçari del të ketë qenë ndër të paktët profesorë të kohës që refuzoi të nënshkruante për t'u anëtarësuar në Partinë Kombëtare Fashiste. Krejt e kundërta, temperamentit i impulsiv dhe i rrembyer, kishte bërë që disa herë të kundërshtonte hapur propagandën që bëhej nga pushtuesit që pretendonin se Italia e kishte çliruar Shqipërinë nga "regjimi i satrapit Zog" dhe se mund të sillte përparimin dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare.

Dëshmi të kolegëve të Pepos, thonë se kundërshtimi i këtyre tezave hapur e çoi dy herë në burgosjen dhe internim, në Itali (1941) dhe në Porto Palermo (1943). Por, përtej dëshmimeve, burime primare për internimin e prof. Pepos në Itali nuk janë mundur të gjenden në kohë për studimin e Sonila Boçit e Kristi Kolçes mbi të cilin bazohet ky artikull. I biri, Leonidha Pepo thotë se i ati u internua pasi në një takim me Francesco Jakomonin, të dërguarin e mbretit të Italisë, kishte thënë: “Kujt i tregoni ju se çfarë është fashizmi! Kujt i thoni ju se fashizmi çliroi Shqipërinë? Trupat tuaja ushtarake në vendin tonë thonë vetëm pushtim, fashizmi nuk sjell ndërtim por robëri”. Për burgosjen e dytë si shkak përmendet reagimi i tij para ministrit të Arsimit, Xhevat Korça. Teksa ministri shprehej se “pavarësia e Shqipërisë është e siguruar [pasi] Shqipërinë e mbron Musolini”, Pepo thuhet t’i jetë përgjigjur se “Shqipëria është e robëruar nën fashizmin...” Pak dihet për jetën e tij në këto internime a kohëzgjatjen që patën. Pas lirim, ai është mësimdhënës në Korçë dhe boton shkrime në shtypin e kohës, mes të tjerash edhe në revistën “Shkëndija” që drejtohej nga Ernest Koliqi (ish-ministër gjatë fashizimit). Prof. Pepo nuk do t’i përmendte më vonë këto bashkëpunime dhe veprimtarinë shkencore që kishte zhvilluar gjatë Luftës. Ai do të heshte për këto, ashtu siç nuk përmendi njohjen me Lef Nosin. Si Nosit edhe Koliqit, regjimi i pas 1944-ës u kishte vënë kryq dhe nën lupë kalonin edhe miqtë e bashkëpunëtorët e tyre.

Por si ndodh që nxënësi që kundërshtoi mbretin Zog, e profesori që kundërshtoi të dërguarin e Mbretit Italian e vetë ministrin nën pushtimin fashistë, për çka ishte internuar, të heshtë në komunizëm, madje, të mësojë marksizëm-leninizmin? Si ndodh që djaloshi që kundërshtoi tiranitë të stepej, të druhej, e ta ndalte hovin e temperamentit të tij të rrëmbyer?

Tirana e vitit 1948 i është dorëzuar pushtetit komunist. Kryeqyteti ka parë të dënohen me ekzekutim e burg, deputetë e intelektualë. Gjyqë të

panumërta publike në salla kinemash, kanë krijuar panik mes qytetarëve shqiptarë. Akuzat dhe dënimet janë transmetuar në radio. Presioni e ka dhënë efektin kudo, e në vend të shpresës, ka frikë. Është kuptuar tashmë se liria që u fitua me luftë u ‘humb’ me vendime qeverie.

Është në këtë kohë, që Petraq Pepo, një prej themeluesve të Institutit të Shkencave është caktuar si bashkautor i hartimit të një teksti zyrtar për Historinë e Shqipërisë. Duhet të ketë kuptuar se sukcesi do të ishte i vështirë për formimin e tij, 45-vjeçari i shkolluar në Perëndim, rezultoi të jetë regjistruar në kurset e marksizëm-leninizmit, pikërisht në kohën kur pjesa e parë Historisë ishte në proces diskutimi. Vite më vonë, kur ishte në pension, ai do i porosiste studiuesit e rinj se në rrugën e kërkimeve shkencore, pos skrupulozitetit në vrojtimin e dokumenteve e përkthimeve, studimet në mënyrë që të botohen “spërkatini pak më pluhurin e marksizëm-leninizmit”.

Duket se vrasjet e dënimet e atyre që kishte njohur e bashkëpunuar e kishin shtrënguar Pepon të kërkonte pluhurin ‘magjik’ të ideologjisë në shkencë. Dritëhijet e pikëpyetjeve mund të gjenden tek atmosfera që mbretëronte në Shqipërinë e izoluar komuniste kur profesori nuk dukej të shihte asnjë dritë që e lidhte me parimet e Francës ku kishte studiuar. Askush nuk lejohej të ikte prej këtu, askush nuk lejohej të mendonte ndryshe.

Përtej atyre detyrave që iu dhanë, Pepo nuk bëri përpjekje të zinte pozicione shtetërore, as të tregonte devotshmëri të theksuar ndaj regjimit. Madje, menjëherë pas çlirimit ai martohet me vajzën e ish-ministrit të Drejtësisë së kohës së Zogut, një veprim që nuk mund të shihej me simpati për regjimin e kohës. Megjithatë nuk ngurronte të thoshte gjithmonë mendimin e vet, Pepo bëri të gjitha përpjekjet të përvetësonte ideologjinë ideologjinë marksiste. Në vitin 1955, ai u regjistrua në kurset e edukimit marksist-leninist, të cilat zhvilloheshin

në Shkollën e Partisë “Vladimir Iliç Lenin” dhe e përfundoi atë me rezultate shumë të larta.

Kristi Kolçe dhe Sonila Boçi mbi studimin e të cilave bazohet ky artikull, ngrenë tezën se si do të mundte një intelektual i edukuar në Perëndim në thelb apolitik, inteligjent dhe ambicioz të gjente vendin e tij në një regjim ku indoktrinimi marksist-leninist ishte në themel të gjithçkaje. “Petraq Pepo është personazh shumë interesant për t’i përgjigjur kësaj teze, pasi ai nuk shfaq asnjëherë entuziazëm, por as armiqësi me regjimin. Ai përpiqet të përshtatet, por herë-herë shpirti i tij rebel nuk e lejon ta bëjë plotësisht këtë gjë”, thonë ato.

Studiueset e gjejnë të vështirë të flasin për pozicionimin e Petraq Pepos pas vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Pepo nuk kishte shfaqur asnjëherë më parë ndonjë preferencë politike, qoftë të majtë, qoftë të djathtë. E megjithatë, ai që kishte kundërshtuar mbretin dhe fashizmin, ishte tanimë një intelektual apolitik që duhej të përshtatej në një sistem që shihte si themel mbijetese edukimin komunist. Historiani që ruante frymën e shkollës së Parisit duhej ta shkruante historinë sipas shkollës marksiste të mendimit historik, me të cilën nuk ishte familjar. Arsyet pse erdhi ky vendim i Pepos, është e vështirë t’i dokumentosh. Por nëse bëhet një analizë mbi të dhënat për veprimtarinë e tij si anëtar i Institutit të Shkencave, vëren se për një studiues të historisë nën regjimin komunist, njohja e teorisë marksiste ishte një nga kushtet thelbësore për të vijuar punën, pavarësisht për cilat periudha të historisë ishin përqendruar studimet.

Studimi vë në dukje se qoftë në faktin që Pepo mbijetoi, qoftë në përshtatjen me regjimin komunist, e ndihmuan disa rrethana. Së pari, njohja me Enver Hoxhën, të cilin e kishte pasur edhe student, edhe koleg. Të dy kishin një ndjenjë të përbashkët dashurie për revolucionin francez, pavarësisht se Hoxha adhuronte Komunën e Parisit dhe jakobinët, ndërsa Pepo, nga sa duket në shkrimet e tij, kishte idhuj iluministët. Së dyti, antifashizmi dhe burgosja e

internimi i tij gjatë Luftës së Dytë Botërore, i kishte siguruar një lloj dashamirësie të krerëve të regjimit.



Së treti, ai asnjëherë nuk shprehu ndonjë kundërshti ndaj regjimit. Së katërti, fushat e tij të studimeve, veçanërisht njohja e marrëdhënieve të hershme të Greqisë me Shqipërinë, e bënë të domosdoshëm për regjimin në kushtet kur atij duhet të rikonfirmonte pavarësinë, kufijtë dhe qeverisjen. Duket se regjimi e pa atë si një nga të paktët intelektualë, të cilëve mund t’i besonte. Në korrik të vitit 1946, prof. Pepo ishte si një nga dy historianët pjesë e delegacionit shqiptar krah udhëheqjes në Konferencën e Paqes në Paris, për të mbrojtur Shqipërinë përballë pretendimeve territoriale greke. Leonidha Pepo pohon se ka qenë pikërisht Enver Hoxha që e kishte përzgjedhur Pepon. Fakti që në konferencë, Shqipëria ruajti kufijtë dhe hodhi poshtë pretendimet fqinje, që edhe një kontribut i e Pepos dhe Aleks Budës. Sot, mendohet që prezantimi dinjitoz në Konferencën e Paqes në Paris, duhet të këtë ndikuar në karrierën e mëvonshme të Petraq Pepos.

Përtej ngurtësisë para regjimit, përtej ‘kontratës së heshtjes’ mes tyre dhe ruajtjes së mesit të artë- i baraslarguar nga disidenti e intelektual i oborrit- ai, diç kishte ruajtur prej rebelimit rinor. Në mbledhjet e punës, ishte një nga njerëzit që nuk kishte frikë

të thoshte mendimin e vet. Në analizën vjetore të vitit 1948, ai i kritikonte drejtuesit për mungesën e transparencës. Më tej, nuk kishte asnjë ngurrim të propozonte studime mbi tema të cilat konsideroheshin të vështira dhe problematike si: studimet mbi pellazgët, apo mbi lashtësinë shqiptare. Nuk qenë të pakta rastet që ngrite problematika të rëndësishme për marrëdhëniet e shkencës me mësimdhënien, siç ishte rasti në mbledhjen e Institutit të Shkencave në vitin 1952, ku “shoku Pepo shtroi çështjen e bashkëpunimit dhe ndihmës që duhet t’i japë instituti, ministrisë së Arsimit për sa i takon përpilimit të teksteve shkollore dhe organizimit të ekspeditave me qëllim që të ndihmohen kuadrot studionjëse të Ministrisë në punimet e tyre origjinale”. Të gjitha propozimet e tij gjetën veshin e shurdhët si të drejtuesve të Institutit, ashtu dhe të drejtuesve të lartë partiakë. Kjo mund ta ketë detyruar studiuesin ambicioz që të kërkojë një mënyrë për të gjetur një rrugë për t’u ndjerë disi më i përfshirë në vendimmarrjen e regjimit të ri.

Boçi e Kolçe thonë se vitet 1947-1954, mund të konsiderohen si vite përshtatje të historianit të edukuar në Francë me një ideologji që ai nuk e ndjente plotësisht të tijën. Përtej ideologjisë, gjatë veprimtarisë së tij shkencore ai ka lanë vepra shumë të rëndësishme për historinë e Shqipërisë. Përkthimi i dokumenteve nga greqishtja e vjetër, ndihmesa për të sjellë në shqip testamentet e Iljaz Bej Mirahorit dhe jo vetëm, japin të dhëna të rëndësishme për Korçën nën sundimin osman, por edhe për organizimin jetës ekonomik dhe sociale në atë periudhë. Përkthimet e tij profesionale, vuajtën për fat të keq, nga idelogjizimi marksist që i imponohej historianëve. Sipas Andi Rëmbecit, studiues i Mesjetës, përkthimeve të Pepos u janë hequr pjesë, të cilat bindin ndesh me ideologjinë e kohës. Duket se profesori bëri disa kompromise për hir të dëshirës për të vijuar pasionin e tij për historinë. I biri, Leonidha i kujton me detaje orët e gjata të prof. Pepos në tryezën e punës. “Babai ishte kampion i shfrytëzimit të arkivave. Qëndronte me orë të gjata duke punuar, gati 8 orë në ditë dhe sigurisht kur kthehej nga puna ai

sërish do ishte duke punuar. Nuk e konceptonte dot që të qëndronte një ditë pa studiuar, ... në dhomën tonë të pritjes nuk futej askush, babai sa kthehej nga puna rifillonte studimin duke u ulur këmbëkryq. E gjithë dhoma ishte e mbuluar me materialet që ai studionte edhe shkruante”, shprehet ai duke qeshur.

Kontributi i tij u vlerësua nga pushteti i kohë me Medaljen e Kujtimit(1950) dhe me dy “Urdhra pune” (1958, 1962). Pepo nuk e ndali punën kërkimore edhe pasi doli në pension më 1968, madje kërkonte me këmbëngulje që të vlerësohej nga shteti. Në Arkivin Qendror të Shtetit janë gjetur disa letërkëmbime të tij me Enver Hoxhën, ku i kërkonte ta ndihmonte për t’iu akorduar çmimi i Republikës (1974) apo të merrte titullin Profesor (1972). “Kam forca të gjalla, - do t’i shkruante Pepo, Enver Hoxhës, kam vullnet për punë, koha nuk më ka mposhtur akoma prandaj kam kërkuar nga Instituti i Historisë të më marrin në punë profesor pensionist”. Vetë këto letra dhe përgjigjet e tyre janë dëshmi e kontrollit të fortë shtetëror mbi shkencën. Me rastin e 70 vjetorit të lindjes, Presidiumi i Kuvendit Popullor i akordoi Urdhërin e Naim Frashëri të Klasit të I-rë.

Kur ndërroi më 1984, ai kishte marrë disa çmime për punën e bërë nën kontrollin e rreptë politik. Ndaj jeta e tij, është një prej atyre jetëve që tregon rrekjen e një intelektualit që jeton në komunizëm të ruajë veten, çka në Shqipëri qe kthyer në mënyrën e të qenit. Sepse, siç do thoshte Mihai Botez, një intelektual rumun që kërkoi strehim politik në SHBA, “ekziston një koncept i trishtë, por i vërtetë që quhet ‘arti i të mbijetuarit’, nën diktaturën komuniste, madje në një mënyrë dinjitoze, i cili përfshin kombinimin e nënshtrimit të kalkulluar, kritikën e vetëkontrolluar, mbajtjen taktike të një profili të ulët dhe përdorimin me inteligjencë i mundësive. Sigurisht për shumë intelektualë perëndimorë, këto strategji duken të çuditshme, madje dhe të neveritshme. Në princip, jam gati të bie dakord me ta, duke shprehur urimin tim të trishtë që atyre të mos iu duhet asnjëherë ta mësojnë këtë art”.

GJERGJ KOKOSHI

Çmimi i kundërshtimit ndaj regjimit

Një burrë i pakompromis, ministri pati forcën morale të dorëzonte detyrën në mënyrë vullnetare kur pa se pushteti po shkatërronte vendin

In 1943, at a time when Tirana was experiencing invasion by two occupying powers in five years, Gjergj Kokoshi, age 39, joined the left-wing National Liberation Front. He was born in Shkodra in 1904, then left his hometown to study philosophy in Italy and France. In Paris he received his PhD in Literature, and in 1930 returned to Albania and worked as a high school teacher in Shkodra and Tirana. Circumstances and the negative influence of Italian Fascism in Albania, as well as his stance against the policies of King Zog, turned him into an anti-Zogist and anti-Fascist. As a result, when he was invited to the First Conference of Albanian Studies in 1940 to mark the establishment of Royal Studies, he refused to attend, citing health issues.

Më 1943, kur Tirana ka ndërruar dy pushtues në 5 vite, Gjergj Kokoshi i bashkohet Frontit Nacionalçlirimtar. Është 39 vjeç. Nga Shkodra ku ka lindur më 1904, ka ikur për të studiuar në Itali dhe Francë për filozofi, është doktoruar në Paris për letërsi dhe në vitet 1930, është kthyer për t'u bërë

profesor në gjimnazin shtetëror në Shkodër dhe në Tiranë. Rrethanat dhe dorëzimi i dalëngadaltë i Shqipërisë nga ndikimi italian në pushtimin fashist, por edhe kundërshtimi i politikave të mbretit, e kanë bërë anti-zogist. Por edhe antifashist. Aq sa më 1940, kur ftohet të jetë pjesë në Konferencën e Parë të Studimeve Shqiptare, që shënoi themelimin e Institutit Mbretënuer të Studimeve, refuzon të për arsye shëndetësore.

Kur lufta kishte filluar, Kokoshi kishte dëshmuar afilacion me partizanët dhe lëvizjen e drejtuar nga Partia Komuniste. Pasi kishte propaganduar idetë antifashiste dhe përhapjen e tyre tek të rinjtë në shkollë, profesori kishte lënë klasat dhe ishte bërë pjesë e rezistencës së armatosur kundër pushtuesit në veri të Shqipërisë, në Dibër, duke arritur të gradohej, deri kolonel.

Emri i tij fillon të bëhet i njohur pas Kongresit të Përmetit, kur nis instalimi i regjimit komunist në Shqipëri. Filozofi i diplomuar edhe për letërsi,



Indermar

Kam pyegatë në këtë konferencë:

Shqipëria dhe banorët e saj gjatë
periodes proto-istorike

Pikat kryesore të kësaj periodes

A. Perioda proto-istorike shqiptare

B. Si ishte bërë jehonë në periodes
si në rishtet e kësaj periodes

C. Dëshmitë dhe në pikë të kësaj periodes

loket, gjatë periodes

1940 - 1941

ishite zgjedhur anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar, strukturë e qeverisjes në atë kohë.

Historiana Enriketa Pandelejmoni, mbi studimin e së cilës bazohet ky artikull, thotë se duhet të jetë propozuar si i ngarkuar me punë për arsimin që gjatë ditëve të Kongresit në maj, pasi emri i tij gjendet në një dokument pa firmë, ndërsa zyrtarisht, Kokoshi u ngarkua më 20 qershor 1944. Enver Hoxha e prezantoi me elozhe të mëdha, si pjesëmarrës i Lëvizjes “njeri që nuk ka bërë kompromise dhe kompetent me eksperiencë në fushën e arsimit”. Katër muaj më vonë, në mbledhjen e Këshillit në Berat, Kokoshi emërohet Ministër i Arsimit në qeverinë provizore të drejtuar nga Hoxha.

Megjithëkëtë, siç mësohet nga Dosja Formulare e ish deputetit Selaudin Toto, edhe gjatë luftës, Kokoshi ishte i pakënaqur nga elementët e majtë ekstremë që ishin në pushtet. Pavarësisht situatës, ish-profesori, organizon Kongresin e Arsimitarëve Antifashistë dhe përpilon platformën për arsimin. Është koha kur pikëpamja e Kokoshit për zhvillimin cilësor të arsimit përplasët me pikëpamjen e Sejfulla Malëshovës për masivizimin e arsimit. Debate mes tyre ka edhe mbi kompetencat e Ministrisë së Kulturës Popullore, si dhe mbi zërin e ulët që i është lënë arsimit në buxhetin e vitit 1945, kur më parë i ishte rezervuar 13 %. Kokoshi nis ta gjejë veten jashtë rryme, teksa ata që fituan luftën po konsolidonin pushtetin. Besonte, se Lëvizja Nacionalçlirimtare nuk qe njëqind për qind e së majtës ekstreme. E dinte se në të kishte edhe të moderuar, por fakti që ata më ekstremistët morën pushtetin, nuk i pëlqente, madje, shkaktonte dëshpërim edhe te shumë të tjerë.

Pas rreth 80 ditësh ministër, përtej përplasjeve, profesori kuptoi që nuk arrinte dot të sillte në jetë vizionin e tij. Gjergj Kokoshi jep dorëheqjen më 13 janar 1945, ndërsa Malëshova është ministër kulture e propagande dhe më vonë ministër Arsimit.

Vijon të jetë pjesë e Këshillit Nacionalçlirimtar i cili në gusht 1945 quhet Fronti Demokratik, por e shpreh hapur kundërshtimin e tij ndaj ligjit të ri zgjedhor, që nuk lejonte pjesëmarrjen në zgjedhje të partive të tjera. Kjo ndodhte kur aleatët ndërkombëtarë, si SHBA e Britania kishin vënë kusht për njohjen e qeverisë, mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në zgjedhjet lokale Partia Komuniste vuri në lista njerëzit e vet, “të sprovuar në luftë, të vendosur dhe besnikë ndaj interesave të popullit”. Tanimë po merrte në duart e veta drejtimin e shtetit, duke eliminuar më parë “përfaqësuesit e reaksionit”. Gjergj Kokoshi kandidoi në zgjedhjet lokale të mbajtura në maj 1945, në Lagjen e Re në Tiranë, por nuk mundi të zgjidhej. Kishte marrë vetëm 17 vota.

Më 27-29 shtator, dy muaj para se të mbaheshin zgjedhjet qendrore të 2 dhjetorit 1945, u miratua një paketë ligjore për to. Ligji elektorale, Ligji mbi Asamblenë Kushtetuese si dhe Ligji mbi listat e votuesve, kufizonin zhvillimin e zgjedhjeve të lira. Fronti Demokratik që drejtohej nga komunistët nuk lejonte krijimin e grupeve të tjera politike, procesi i administrimit të votimit, nga komisionet te mbikëqyrësit sipas historianes Sonila Boçi ishte në duart e tyre.

Pakënaqësitë ishin të mëdha. Që kur ishin bërë diskutimet mbi hartimin e ligjit, Gjergj Kokoshi, në atë kohë Ministër i Arsimit, por dhe anëtar i Këshillit të FANÇ ishte shprehur se nuk ishte i përshtatshëm me parimet demokratike. Ai doli hapur kundra miratimit të tij duke argumentuar se cenonte vendosjen e një rendi demokratik dhe pluralist. Vërejti se në kushtet e pasluftës, ligji nuk u mundësonte njerëzve të arsimuar dhe të kualifikuar të kontribuonin dhe nuk u jepte kohën e mjaftueshme grupimeve jashtë Frontit për t’u organizuar dhe paraqitur kandidaturat e tyre. Ai theksonte se kjo binte ndesh me parimet e demokracisë liberale. I dorëhequr nga posti i ministrit, në mbledhjet e Këshillit ku ende ishte pjesë, Kokoshi, ngulmonte të vinte në dukje dëmet e politikave të ashpra ekonomike, që sipas tij, mund

të justifikoheshin për kriminelët e luftës, por jo të merreshin masa të rrepta e rekuizim pasurie ndaj familjeve së tyre, sidomos kur personat në fjalë kishin vdekur. Ai këshillonte kujdes për tatimin e jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, sepse siç po bëhej, ishte kthyer në makth për tregtarët.

I dorëhequr dhe në kushtet kur zëri i tij nuk dëgjohej, ndërsa masat e marra kishin shkaktuar frikë kudo, Gjergj Kokoshi vendos të rimendojë pozicionin e tij brenda Frontit dhe mundësinë e largimit. Ai e dinte se në publik flitej kundra Frontit, e dinte se s'kishte liri dhe se vendi ishte në diktaturë, ndaj e shihte veten në zgjedhje jashtë listave të tyre. Prej kohësh, duke e njohur natyrën e tij, antikomunistë të tjerë e kishin kontaktuar që të organizohej me ta, ndonëse ndjehej pezmi mbi mënyrën si po bëheshin zgjedhjet dhe frika e kandidimit jashtë Frontit.

Kishte takuar disa herë intelektualë si Shefqet Beja, Selaudin Toto, Riza Dani, Kosta Boshnjaku, Kol Kuçali, Irfan Majuni e Musine e Salim Kokalari, duke shpresuar të mbështetja amerikane për të formuar një parti klandestine, me parime të demokracive perëndimore. Ishte menduar të shtrihet ndikimi tek shtresat e pakënaqura sociale dhe të prekurit nga regjimi i ri, tregtarë, pronarë, çifligarë dhe intelektualë me parime të kundërta me pushtetin popullor. Kokoshi propozon që në fillim, themelimin e një opozite dhe daljen si parti më vete në zgjedhjet e 2 Dhjetorit, edhe pse e kundërshtuan dhe e këshilluan që më mirë të rrinin brenda Frontit Demokratik se sa të dilnin më vete. Doemos, një organizim politik nën presionin e kohës e një ligji elektoral që nuk u jepte hapësirë, kishte jo vetëm mendime ndryshe por edhe përplasje.

Ishin bashkë me të grupi socialdemokrat i Musine Kokalari por edhe simpatizanti i monarkistëve Qenan Dibra. E gjithë kjo, bëhej në kushtet e një terrori politik të nisur me gjyqet speciale e gjyqet e popullit të marsit 1945 në fillim ndaj “kriminelëve të luftës”, e më pas ndaj antikomunistëve në Veri.

Megjithëse situata nuk i favorizonte organizimet politike kundër qeverisë, presioni i ndërkombëtarëve, lejimi i gazetarëve të huaj në fushatë dhe në votime u bënë nxitës që jokomunistët të dilnin me listat e veta në zgjedhje. Me vetëm dy muaj kohë, në takimet e fshehta u kuptua që do ishte e vështirë të siguroheshin firmat e nevojshme për të shpallur kandidaturat apo grupin politik. U mbledhën vetëm 25-30 firma, krejt të pamjaftueshme. Më 17 Nëntor 1945 grupi doli me emrin “Bashkimi demokratik”, si bashkim i rrymave politike me qëllim formimin e një opozite.

Në këtë kohë, Kokoshi kupton që është i nevojshëm hartimi i një programi dhe i një lutjeje, të nënshkuara prej disa “njerëzve të ndershëm me qëndrim politik korrekt”. Programi ngjante me atë Frontit Demokratik, ndaj Kokoshi thotë se është kundra politikës së qeverisë shqiptare, që “don me bashkue Shqipërinë me Jugosllavinë”. Për të, ky bashkim ishte kundra vullnetit të popullit shqiptar, i cili “don që Shqipëria të mbetet shtet independent dhe sovran, na duhet ta rujm një shtet të tillë, por pa Gjirokastër e pa Korçë nuk ka shtet shqiptar”. Për çështjen e Kosovës, ndryshe nga të tjerët sugjeron të lihet mënjane për momentin “pasi Jugosllavia na ndihmon për me rujt integritetin tokësor”. Studiuesja Enriketa Pandlejmoni shprehet se Gjergj Kokoshi kishte besim tek misionet britanike dhe amerikane në Shqipëri dhe tek influenca e tyre mbi qeverinë shqiptare për t'i bërë presion për zgjedhjet e shtyrjen e tyre. Me naivitet dhe për habinë e pjesëmarrësve në mbledhje ai thotë se programi dhe lutja duhej t'i dërgoheshin qeverisë shqiptare, pasi ai kishte biseduar me Gjeneralin britanik Hodgson. Logjika e drejtë e Kokoshit, mbi hapat që ndërmerren para zgjedhjeve për një grupim të ri politik, bëheshin në kohën e gabuar. Ai ende nuk e kish kuptuar.

Propozimi i tij pritet me skepticizëm nga pjesëmarrësit në mbledhje. E dinin që po të informonin qeverinë për formimin e kësaj partie, rezikonin të arrestoheshin. Por Kokoshi këmbëngulte

duke shtuar se duhej marrë parasysh edhe arrestimi në momentin që po krijonin një parti opozitare si Bashkimi Demokrat që përfshinte të pakënaqurit, monarkistët e social-demokratët. Ishte rënë dakord që kryesia e opozitës t'i lihej Kokoshit. Drejtimi i besohej profesorit se njihte mirë rininë në shkolla e gjimnaze dhe do të mund ta organizonte atë. E shihnin si personin më të përshtatshëm pasi kishte qenë në Front, kishte luftuar, kishte qenë ministër dhe ishte një personalitet i njohur për aleatët.

Vetë Gjergj Kokoshi ishte marrë me vënien në dijeni të Aleatëve Perëndimorë. Ata u informuan për formimin e një grupi opozitar, ku bashkoheshin përfaqësues të disa tendencave politike me program dhe degë në qytetet kryesore të Shqipërisë. Kokoshi u tha anglezëve se në rast se zgjedhjet do të ishin të lira, opozita fitonte 20-30%, ndaj u duhej mbështetja e tyre.

Më 20 nëntor u vendos që t'u dërgohej misioneve ndërkombëtare një notë mbi shtyrjen e zgjedhjeve, formën demokratike të regjimit pas tyre dhe mundësinë e kthimit të mbretit Zog në Shqipëri nëse e vendosnin votuesit. Në një mbledhje tjetër u hartua një memorandum ku bëhej me dije se zgjedhjet nuk mund të zhvilloheshin lirisht sepse populli do e votonte Frontin (Nacionalçlirimtar) nga frika. Memorandumi i opozitës së drejtuar nga Kokoshi përmbidhte çfarë po ndodhte në vend dhe cili që ndryshimi që ofronin ata.

Theksohej se komunistët luftuan dhe premtuan një sistem demokratik, ndaj të rinjve nuk u shkoi në mendje se po niste ngritja e një regjimi komunist në Shqipëri. Kujtohej se Fronti nuk lejonte formimin e një partie tjetër as shkëputjen prej frontit. "Në të dy rastet akuzohen si sabotatorë, fashista dhe reaksionarë 'rasti i prof. Gjergj Kokoshit, më parë ministër i Arsimit në qeverinë e Enver Hoxhës e tregon qartë këtë gjë", - nënvizonte memorandum, duke shtuar se në nëntor

1945 "të trija fuqitë, pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ndarja e të cilave garanton një regjim me liri politike, në fakt janë një përzjerje". Njëherësh informohej se "të katër liritë (e fjalës, e fesë, e nevojës dhe e frikës) janë shkelur nën këmbë". Përmendeshin të vrarët egërsisht gjatë ditëve të para të regjimit, ushtria e madhe, administrata e fryrë dhe theksohej se Ligji i Bujqësisë kishte bërë konfiskime duke u lënë pronarëve aq pak tokë sa nuk mund të siguronin jetesën. Grupi opozitar shprehej se nuk ishte armik i komunizmit, por kundërshtar politik në një kohë që shkelen liritë nga një qeveri despotike. Në programin e vet, opozita ofronte vendosjen e menjëhershme të lirisë së plotë politike, fetare dhe mediatike, mbrojtje përpara ligjit dhe përpara gjyqit me gjykatës të zgjedhur. Anëtarësimin e vendit në organizatat ndërkombëtare, marrëdhënie miqësore me aleatët e me fqinjët, integritet tokësor, përmirësim material dhe moral të kushteve të jetës së klasës punëtore, lejimin e punëtorëve dhe fshatarëve në jetën politike, etj. Duke qenë se memorandum u drejtohej misioneve të huaja në vend, opozita kërkonte t'i thuhej botës situata e vërtetë e vendit.

Por kur ua dorëzuan dy ushtarakëve anglezë, Palmer dhe Arnott në Misionin e tyre në Tiranë, morën përgjigje se ishin shumë vonë dhe pak shpresë kishte për shtyrjen e zgjedhjeve, por sidoqoftë do t'ia dorëzonin gjeneralit Hodgson. Koloneli Palmer dhe Majori Arnott më vonë do të mohonin t'i kishin bërë premtime konkrete opozitës. Ata pranonin që u ishte dhënë një program dhe një memorandum që nënkuptonte marrjen e pushtetit në rugë demokratike dhe paqësore, me zgjedhjet të lira. Por, nga memorandum kërkohet, se nëqoftëse një numër i madh prej tyre do të arrestoheshin, atëherë britanikët duhet t'i mbështesnin. Majori Arnott pranonte takimet e shpeshta me grupin opozitar por shprehej se planet e tyre i ishin dukur të dobëta, se ishin joefektivë, të përçarë dhe nuk i kishin dhënë besim se do të ruanin konfidencialitetin

e bisedave me të.

Bashkimi Demokratik hodhi idenë e një kryengritjeje kundër regjimit komunist dhe te një demonstratë para zgjedhjeve, më 28 Nëntor për Festën e Pavarësisë. Qe përgatitur madje edhe një thirrje për popullin.

Demonstrata nuk u mbajt, prej frikës së survejimit. U hodhën vetëm trakte kundra pushtetit. Misionet e huaja nuk ndërhyjnë pranë qeverisë shqiptare për të shtyrë zgjedhjet. Zhgënjimi dhe hidhërimi që i madh. Musine Kokalari i rrëfente në fshehtësi nipit më 1972 se, "Aleatët nuk i ndërhyjnë qeverisë dhe heshtën mbi një çështje, e cila, logjikisht, rezultoi si e pashmangshme për dënimin e firmosësve. Një nga një firmëtarët u arrestuan me akuzën për rrëzim të qeverisë. Pasojat për të gjithë këta njerëz janë thjeshtësisht të imagjinueshme".

E ardhmja që fatale për Bashkimin Demokratik që ndërkohë ishte survejuar nga strukturat e Seksionit të Mbrojtjes Popullore (Sigurimi). Katër informatorë dhe bashkëpunëtorë të tij ishin vënë brenda opozitës. Goditja ishte e afërt. Në dhjetëditëshin e parë të 1946-ës filluan arrestimet. Mes të parëve që arrestuan ishte edhe Gjergj Kokoshi e Musine Kokalari, por në total 37 vetë u futën në qeli. Gjyqi ndaj tyre nisi 6 muaj më vonë në Tiranë. Ishte data 17 qershor 1946. Në Kinema Nacional në prani të një populli "të zgjedhur" dhe gazetarëve vendas, gjykimi zgjati 15 ditë dhe u transmetua në radio, që ta dëgjonin njerëzit në çdo skaj të Shqipërisë. Ishin para Gjykatës së Lartë Ushtarake. I akuzuan se ishin mbledhur për të rrëzuar me dhunë pushtetin popullor, për të shkaktuar një ndërhyrje të imperialistëve të jashtëm, që të kishte vetëvrasje e të bënin atentate kundra udhëheqësve.

Gjergj Kokoshi, që e kish marrë parasysh edhe

arrestimin, akuzohej se kishte udhëzuar e frymëzuar për të tërhequr sa më shumë elementë; akuzohej se i kishte mësuar të përpilonin nota për misionin e huaj dhe se kishte shfrytëzuar vendin, emrin dhe kredinë që i kishte dhënë Fronti për të sabotuar e përmbysur pushtetin.

Profesori, i diplomuar në filozofi e letërsi, ish-kolonel, ish-ministër e ish kryetar opozite vendos të mbajë një fjalë në mbrojtje të tij. Vetë fjala mungon në aktet gjyqësore, por ka mbërritur deri sot fraza e tij që pohonte se "qeveria komuniste nuk përfaqësonte vullnetin e popullit", ndaj ai i ishte bashkuar opozitës. Duke e ditur se gjyqi ishte farsë ai vendos të mos flasë më dhe thjesht pyet se "çka ishte në kundërshtim me ligjet shtetërore në fuqi?"

Më 2 Korrik 1946 u dhanë dënimet për 37 persona, prej të cilëve 8 u pushkatuan dhe të tjerët u dënuan me 2 deri në 30 vjet. Informatorët e Sigurimit u dënuan minimalisht ose u liruan si të pafajshëm.

Kokoshi dënohet me 30 vite burg, punë të detyrueshme, humbjen e të drejtave qytetare dhe politike e konfiskimin e pasurisë. Pas gjashtë muajsh në Tiranë, dërgohet në Burgun e Sigurisë së Lartë në Burrel. Opozita që drejtoi, Bashkimi Demokratik, nuk arriti të dilte në zgjedhjet e 2 Dhjetorit 1945 dhe anëtarët e saj u arrestuan kudo. Dënimi i tij do të mbaronte më 23 janar 1976, por ai ndërroi jetë në Burgun e Burrelit më 1961 në moshën 57-vjeçare. Vuante nga tuberkulozi dhe kushtet e këqija duhet ta kenë përshpejtuar ikjen. 18 vitet e fundit të jetës, prej kur iu bashkua luftës qenë një udhëtim drejt vdekjes. Gjergj Kokoshi nuk ishte martuar kurrë dhe nuk la fëmijë. Mundi të linte vetëm shembullin se si njeriu heq dorë nga pushteti kur sheh se ai po e ha shtetin dhe liritë e qytetarëve. Mundi të vërtetonte edhe fjalët e Enver Hoxhës për të, kur e cilësonte si njeri të pakompromis.

